



RAPORTI VJETOR 2023

ANNUAL REPORT 2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE

RAPORT VJETOR
2023





Shtypur në shtypshkronjën Kristalina-kh

Përkthimi: Adelina Albrahimi

E drejta e autorit © Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë

ISBN: 9789928309853

Përmbajtja

Hyrje	7
KUADRI KUSHTETUES PËR FUNKSIONIMIN DHE ORGANIZIMIN E GJYKATËS	9
Përbërja e Gjykatës	11
Anëtarët	12
VENDIMMARRJA	20
TË DHËNAT STATISTIKORE	45
BASHKËPUNIMI DHE PERSPEKTIVA NDËRKOMBËTARE	53
Aderimi i Gjykatës Kushtetuese në organizma ndërkombëtarë	53
Aktivitete jubilarë	55
Veprimtari ndërkombëtare dhe vizita studimore	56
Fotografi	58

Hyrje

Viti 2023 ishte një vit tejet angazhues dhe mobilizues për Gjykatën Kushtetuese. Trupa gjyqësore, tashmë tërësisht me përbërje të re, si një reflektim i ndryshimeve kushtetuese, ka trajtuar çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me mosmarrëveshjet kushtetuese, konfliktet e kompetencave mes organeve të pushteteve, kushtetutshmërinë e nismave ligjore dhe akteve të tjera normative dhe, sigurisht, respektimin e lirive dhe të drejtave të individit, si një nga aspektet më të reja të kontrollit kushtetues. Duke u kujdesur maksimalisht për respektimin e afateve procedurale të shqyrtimit gjyqësor, por duke synuar në radhë të parë cilësinë e vendimmarrjes së saj, Gjykata ka arsyetuar 353 vendime, prej të cilave 70 vendime përfundimtare, 245 vendime moskalimi të Kolegjeve të Gjykatës dhe 38 vendime moskalimi të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

Pavarësisht ngarkesës së çështjeve dhe vështirësive që mbart procesi kushtetues, Gjykata ka bërë përpjekje të vazhdueshme edhe për përmbushjen e objektivave të saj strategjike e institucionale, me qëllim dhënien e një drejtësie kushtetuese funksionale, me integritet dhe besueshmëri të lartë publike. Edhe pse në kushtet e një buxheti të pamjaftueshëm për nevojat e saj, si një institucion i pavarur dhe i riformësuar, Gjykata, me një lidhshmëri dhe vizion të ri të trupës, ndërmori nisma konkrete për përmirësimin e veprimtarisë funksionale në disa drejtime:

Miratimi i Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës së Gjykatës Kushtetuese. Me synimin për ta bërë sa më efektive veprimtarinë e saj administrative, duke iu referuar edhe ndryshimeve që pësoi kuadri ligjor për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, pjesë e paketës së reformës në drejtësi, Mbledhja e Gjyqtarëve miratoi një rregullore tërësisht të re të organizimit dhe funksionimit të administratës së Gjykatës. Kjo nismë detajoi dhe plotësoi kuadrin rregullator institucional lidhur me funksionet dhe detyrat, të drejtat e përgjegjësitë e stafit administrativ.

Miratimi i Rregullores për Komunikimin e Gjykatës Kushtetuese me Median dhe ridimensionimi i marrëdhënieve me median dhe publikun. Për Gjykatën Kushtetuese media është një prej partnerëve kryesorë për sigurimin dhe shpërndarjen e informacionit të saktë dhe të plotë në lidhje me veprimtarinë e saj, duke pasur në fokus ruajtjen e pavarësisë, paanshmërisë

dhe integritetit të kësaj Gjykate. Për këtë arsye u hartua dhe miratua një rregullore e posaçme për komunikimin dhe marrëdhënien e saj me median. Ky dokument përcaktoi parimet, rregullat dhe procedurat e veçanta për krijimin e lehtësive dhe për aksesimin e informacionit nga përfaqësuesit e medias, pra akreditimin e gazetarëve, në funksion të ushtrimit të misionit të tyre për informimin në kohë, me përgjegjësi dhe me korrektesë të publikut. Për shkak të rëndësisë që ajo i kushton komunikimit me median dhe publikun, si dhe në përmbushje të detyrimit për informimin e publikut, Gjykata ka filluar të ndjekë një praktikë të re, që konsiston në organizimin e konferencave për shtyp në ato raste kur për shkak të rëndësisë së çështjes kushtetuese dhe interesit të lartë publik, është e nevojshme të sigurohet informimi i plotë dhe i saktë në lidhje me vendimmarrjen. Qëllimi i këtyre konferencave, në të njëjtën ditë që merret vendimi, është dhënia e një informacioni të përmbledhur dhe me një gjuhë më të thjeshtë, në mënyrë që vendimi i Gjykatës të jetë lehtësisht i kuptueshëm dhe i perceptueshëm, duke pasur parasysh se vendimet kanë gjuhë teknike dhe arsyetimi i tyre i plotë bëhet brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit.

Nga muaji qershor i vitit 2023 Gjykata siguron transmetimin live, përmes platformës Youtube, të të gjitha seancave plenare publike, duke mundësuar ndjekjen e tyre jo vetëm nga palët e interesuara dhe profesionistët e së drejtës, por edhe nga publiku i gjerë. Gjykata, gjithashtu, ka hapur edhe faqen e saj zyrtare në rrjetin Facebook (Meta) krahas llogarive zyrtare në rrjetet sociale "Twitter" (X) dhe "LinkedIn", çka mundëson një instrument tjetër komunikimi me publikun e gjerë. Gjykata ka filluar gjithashtu punën për rikonceptimin e faqes së saj të internetit, me qëllim që ajo të kthehet në një faqe bashkëkohore dhe lehtësisht e përdorshme. Ajo është e ndërgjegjshme se faqja zyrtare përbën një mjet kryesor komunikimi dhe informimi jo vetëm për subjektet palë në gjykimin kushtetues, por për të gjitha institucionet, për profesionistët e studiuesit e së drejtës, shoqërinë civile, përfaqësuesit e medias dhe qytetarët e thjeshtë. Duke pasur këtë në vëmendje, Gjykata planifikon ta riorganizojë dhe plotësojë përmbajtjen e faqes për ta bërë atë të aksesueshme nga çdo përdorues. Sipas formatit të ri, i cili pritet të vihet në përdorim gjatë vitit 2024, çdokush do të ketë mundësi

që nëpërmjet kompjuterit ose pajisjeve të tjera elektronike të orientohet lehtësisht për marrjen e informacionit.

Udhërrëfyesi i Jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese. Hartimi dhe pasja e një udhërrëfyesi (Guide) të jurisprudencës kushtetuese ishte shfaqur si një domosdoshmëri dhe përbënte një vakuum, për të cilin nevojitej një nismë urgjente. Udhërrëfyesi është një nga mjetet kryesore që e ndihmon Gjykatën të ruajë vazhdimësinë e jurisprudencës dhe të sigurojë uniformitetin e saj. Ai rrit cilësinë e vendimarrjes, nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, ndihmon profesionistët e praktikantët e së drejtës, si dhe publikun që përmes njohjes me vendimin e Gjykatës të përmirësojnë cilësinë e ankimit kushtetues, për një mbrojtje më efektive të të drejtave kushtetuese. Udhërrëfyesi i jurisprudencës kushtetuese u konceptua duke konsideruar si model udhërrëfyesit e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ai pasqyron dhe përmbledh jurisprudencën kushtetuese për ankimin kushtetues individual me fokus në të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, duke synuar që kjo nismë të vijojë edhe për të drejtat dhe liritë e tjera themelore të individit. Për herë të parë në këtë format, me një volum të konsiderueshëm, ky material paraqet në mënyrë të strukturuar standardet dhe precedentët e zhvilluar nga Gjykata ndër vite në lidhje me këtë të drejtë.

Organizimi i tryezave të përbashkëta me Gjykatën e Lartë. Një dimension tjetër i rëndësishëm i veprimtarisë së Gjykatës është edhe diskutimi i çështjeve të natyrës kushtetuese që janë evidentuar nga Gjykata Kushtetuese në vendimarrjen e Gjykatës së Lartë. Për këtë, gjatë vitit 2023 janë organizuar tryeza pune me gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, të cilat kanë synuar forcimin e dialogut mes dy juridiksioneve, atij kushtetues dhe atij gjyqësor të zakonshëm, për një mbrojtje më të mirë të të drejtave të individit, veçanërisht në drejtim të së drejtës për proces të rregullt dhe aksesit në të drejtat substanciale.

Sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve. Numri në rritje i kërkesave kushtetuese drejtuar Gjykatës ka diktuar gjithmonë e më shumë nevojën e kompjuterizimit të procesit të punës për administrimin e këtyre kërkesave. Në këtë drejtim,

referuar parimit të efikasitetit dhe transparencës, Gjykata ka bërë përpjekje të vazhdueshme për realizimin e një sistemi bashkëkohor elektronik të menaxhimit të çështjeve. Përgjatë vitit 2023 Gjykata siguroi angazhimin e partnerëve të saj ndërkombëtarë për të mbështetur krijimin e një sistemi tërësisht të ri, të bazuar në teknologjinë e informacionit, për një shqyrtim cilësor e efikas të çështjeve, i cili pritet të materializohet gjatë viteve 2024-2005.

Duhet thënë se veprimtaria e kryer nga Gjykata Kushtetuese gjatë vitit 2023 ishte impenjuese por, përtej sfidave, krijoi edhe mundësi e oportunitete për drejtësinë kushtetuese në vend. Trupa e re, e përbërë me anëtarë të cilët vijnë nga përvoja, formime e fusha të ndryshme të së drejtës, ka sjellë një diversitet të dobishëm, i cili i shërben mendimit ligjor dhe ka sjellë realizime të rëndësishme, duke u kthyer në një nga pikat më të forta institucionale.

Për vitin 2024 ashtu edhe më tej, sfida e çdo anëtari të Gjykatës Kushtetuese do të jetë dhënia e drejtësisë kushtetuese dhe përmbushja e misionit të shenjtë të interpretimit përfundimtar të Kushtetutës, zgjidhjes së mosmarrëveshjeve kushtetuese, garantimit të parimeve të demokracisë dhe shtetit të së drejtës, si edhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të individit.

HOLTA ZAÇAJ LL.M.
KRYETARE E GJYKATËS KUSHTETUESE



KUADRI KUSHTETUES PËR FUNKSIONIMIN DHE ORGANIZIMIN E GJYKATËS

Gjykata Kushtetuese, e konceptuar sipas modelit kelsenian, ashtu si gjykatat e tjera simotra të të njëjtit sistem, u krijua si një gjykatë e specializuar që zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe thotë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i ka njohur Gjykatës funksionin themelor të interpretimit përfundimtar të normës kushtetuese dhe kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve e akteve të tjera normative. Nëpërmjet kontrollit kushtetues Gjykata vlerëson mënyrën se si ushtrohet pushteti nga organet shtetërore duke përcaktuar kufijtë kushtetues brenda të cilëve duhet të veprojnë ato. Për këtë arsye ajo njihet ndryshe edhe si “Rojë e Kushtetutës”.

Ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, mes të tjerash, ridimensionuan Gjykatën Kushtetuese edhe si një gjykatë të të drejtave të njeriut, duke zgjeruar rolin e saj në mbrojtje dhe garantim të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, nëpërmjet ankimit kushtetues individual, i cili mund të ushtrohet ndaj çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që i cenon ato.

Juridiksioni i Gjykatës përcaktohet në nenin 124 të Kushtetutës, ndërsa kompetencat e saj renditen në nenin 131 të Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata vendos për:

- pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në nenin 122 të saj;
- pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën para ratifikimit të tyre;
- pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare;
- mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore;

-kushtetutshmërinë e partive dhe organizatave të tjera politike si dhe të veprimtarisë së tyre në bazë të nenit 9 të Kushtetutës;

-shkarkimin nga detyra të Presidentit dhe vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve të tij;

-çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmërinë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit dhe të deputetëve, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre;

-kushtetutshmërinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij;

-gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë;

-respektimin e procedurës së parashikuar nga Kushtetuta në rastet e shqyrtimit të një ligji për rishikimin e Kushtetutës, të miratuar nga Kuvendi sipas nenit 177 të saj.

Kushtetuta parashikon shprehimisht edhe kompetenca të tjera të Gjykatës Kushtetuese,¹ siç janë:

-shqyrtimi i vendimit të Këshillit të Ministrave për shpërndarjen ose shkarkimin e organit të zgjedhur drejtpërdrejt të njësisë qeverisëse vendore për shkelle të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve;

-shqyrtimi i vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit dhe prokurorit;

-shkarkimi dhe pezullimi nga detyra i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

-shqyrtimi i ankimeve ndaj vendimeve për masat disiplinore ndaj inspektorëve të tjerë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

¹ Ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 parashikuan ngritjen e një sistemi të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve për një periudhë 9-vjeçare, periudhë gjatë së cilës pranë Gjykatës funksionon edhe Kolegji i Posaçëm i Apelit, i cili, veç të tjerash, ka edhe juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

Subjektet të cilat mund të vënë në lëvizje Gjykatën janë:

- Presidenti;
- Kryeministri;
- jo më pak se një e pesta e deputetëve;
- Avokati i Popullit;
- Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- çdo gjykatë;
- çdo komisioner i krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta;
- Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
- organet e qeverisjes vendore;
- organet e bashkësive fetare;
- partitë politike;
- organizatat;
- individët.

Ndërsa katër subjektet e para janë të pakushtëzuara, subjektet e tjera kërkohet që të justifikojnë interesin e tyre në çështjen kushtetuese të ngritur para Gjykatës.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim. Vendimet përfundimtare merren nga shumica e të gjithë anëtarëve të Gjykatës, pra prej pesë gjyqtarësh. Vendimet në fazën e shqyrtimit paraprak të kërkesave merren nga Kolegji i Gjykatës, i përbërë nga tre anëtarë, ose nga Mbledhja e Gjyqtarëve.

Zbatimi i vendimeve të Gjykatës përbën një detyrim kushtetues, për sa kohë Kushtetuta shprehet qartësisht për forcën detyruese që kanë ato mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Vendimet e Gjykatës hyjnë në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare ose në një datë tjetër të përcaktuar në vendim. Në ligjin organik të Gjykatës parashikohen rastet kur vendimet e saj kanë efekte prapavepruese.² Gjithashtu, në ligjin organik dhe në Rregulloren për Procedurat Gjyqësore detajohen procedurat dhe rregullat e paraqitjes, pranimit dhe kontrollit administrativ të kërkesave, si dhe mënyra e funksionimit dhe e vendimmarrjes, deri në publikimin e vendimit.

² Ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" (ndryshuar me ligjet nr. 99/2016 dhe nr. 45/2021).

Përbërja e Gjykatës



Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë anëtarë, tre prej të cilëve emërohen nga Presidenti i Republikës, tre zgjidhen nga Kuvendi dhe tre nga Gjykata e Lartë. Kjo formulë e re ishte pjesë e ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, ndërkohë që sipas parashikimeve të mëparshme anëtari i Gjykatës emërohej nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit. Formula aktuale synon të garantojë një proces transparent përzgjedhjeje, të bazuar mbi kriteret e meritës së kandidatëve, si dhe parashikon përfshirjen në proces të një organi tjetër, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i cili verifikon plotësimin e kriterëve të kandidatëve dhe bën renditjen përfundimtare të tyre. Më tej, organi i emërtesës përzgjedh gjyqtarin kushtetues ndërmjet kandidatëve të renditur në tri vendet e para.

Mandati i gjyqtarit kushtetues ka mbetur i pandryshuar, ai është 9 vjet, pa të drejtë riemërimi. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese fillon detyrën pasi bën betimin para Presidentit të Republikës dhe ai vazhdon në detyrë deri në zgjedhjen e pasardhësit të tij.

Mandati i gjyqtarit kushtetues mbaron kur mbush moshën 70 vjeç, përfundon mandatin, jep dorëheqjen, shkarkohet sipas parashikimeve kushtetuese ose kur vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë e të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit apo të pamundësisë për të ushtruar detyrën.

Gjyqtari gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tij, përveç rasteve kur ka vepruar për një interes vetjak ose me keqbesim. Ai mban përgjegjësi disiplinore sipas ligjit. Ndërkohë që Kushtetuta ka ndaluar kryerjen e çdo veprimtarie tjetër me natyrë politike, shtetërore, si dhe profesionale kundrejt pagesës, ajo lejon ushtrimin e veprimtarisë së mësimdhënies, asaj akademike dhe shkencore në kushtet e parashikuara nga ligji.

Në historikun e Gjykatës, për sa i përket përfaqësimit gjinor, anëtarët gjyqtare kanë qenë më të pakta në numër krahasuar me anëtarët meshkuj. Që prej vitit 2019 dhe aktualisht dy të tretat e anëtarësisë së Gjykatës përbëhet nga gjyqtare femra.

Trupa gjyqësore mbështetet nga administrata e Gjykatës Kushtetuese e përbërë nga këshilltarët ligjorë, stafit i Kabinetit të Kryetarit, nëpunësit civilë dhe punonjësit mbështetës. Gjatë vitit 2023, Gjykata ka administruar buxhetin e saj në vlerën 237,783,000 Lekë.


Anëtarët





Holta Zaçaj, LL.M, Kryetare

Lindur në vitin 1976 në Tiranë. Diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, në vitin 1998. Në periudhën 2007-2008 ka kryer masterin shkencor për "Titujt dhe rregullimet financiare", në Universitetin e Georgetown në SHBA, në kuadër të programit Fullbright. Rugëtimin profesional e ka nisur si juriste dhe aktiviste për të drejtat e njeriut, duke u angazhuar, në vitet 1999-2001, në Qendrën "Paqe nëpërmjet Drejtësisë", projekti për krimet e luftës në Kosovë. Më pas, është angazhuar si avokate në Qendrën e Praktikave dhe Shërbimeve Ligjore të Integruara (QSHPLI), në projektet e ndihmës ligjore falas, si: Klinika Ligjore për të Miturit, Zyra e Avokatit të Qytetit pranë Bashkisë Tiranë, Klinika Ligjore për Refugjatët. Nga viti 2008, krahas angazhimit në shoqërinë civile si avokate dhe eksperte e të drejtave të njeriut, ka punuar si avokate në zyrën e avokatisë "Delegibus Consulting" sh.p.k. dhe nga viti 2018 ka ushtruar profesionin e avokatit edhe në shtetin e Massachusetts, SHBA, në zyrën ligjore "Ligris and Associates" dhe "Zaçaj Law". Gjithashtu, në periudhën 2003-2013, zonja Zaçaj është angazhuar si lektore në Shkollën e Magjistraturës në trajnimin fillestar, në të drejtën familjare dhe në trajnimin vazhdues në fushën e së drejtës familjare dhe të të drejtave të fëmijëve, si dhe lektore e së drejtës bankare dhe financiare në disa universitete private në Shqipëri, në periudhën 2009-2014. Zonja Zaçaj është angazhuar dhe ka kontribuar si eksperte ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare në një sërë iniciativash të UNICEF-it në Shqipëri, UNICEF-it në Kosovë, UNICEF-it në Gjeorgji, Këshillit të Evropës, Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar etj. Gjatë periudhës 2013-2018 ka qenë Drejtore e Departamentit Ligjor të Alpha Bank sh.a. Ajo është autore dhe bashkautore e rreth 30 studimeve dhe botimeve në fushën e të drejtave të njeriut, të të drejtave të fëmijëve, të së drejtës familjare, të së drejtës bankare dhe të titujve. Ajo është bashkautore e Kodit të Familjes, ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri, paketës ligjore për trajtimin penitenciar të të miturve në Kosovë. Në muajin janar të vitit 2023 është emëruar anëtare e Gjykatës Kushtetuese. Më 20 shkurt 2023 është zgjedhur në detyrën e Kryetarit nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.



Marsida Xhaferllari, anëtare

Lindur në vitin 1975 në Tiranë. Diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitin 1997. Në vitet 1997-2000 ka kryer studimet në Shkollën e Magjistraturës, në brezin e parë të të diplomuarve të kësaj shkolle, dhe është emëruar në detyrën e gjyqtarës. Ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier gjatë viteve 1999-2007. Në dhjetor të vitit 2007 ka ushtruar në strukturat juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë detyrën e këshilltares së ministrit, detyrën e drejtoreshës së përgjithshme të Drejtorisë së Kodifikimit dhe atë të drejtoreshës së përgjithshme të Çështjeve të Drejtësisë. Për shkak të këtyre detyrave ka qenë pjesë e disa komisioneve apo këshillave drejtues, si Komisioni i Etikës së Konferencës Gjyqësore Kombëtare, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore apo Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit. Në janar të vitit 2013 është emëruar në detyrën e Kryeinspektore të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Që prej vitit 2005 është angazhuar në vijimësi në aktivitete mësimdhënieje, duke përfshirë edhe Programin Fillestar dhe Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, si dhe ka qenë eksperte ligjore në projekte të lidhura me sistemin e drejtësisë. Në periudhën 2015-2016 ka qenë pjesë e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë të Reformës në Drejtësi, duke punuar për ligjet për gjyqësorin dhe financimin e gjyqësorit. Është autore e disa manualeve të punës për çështje të hartimit të legjislacionit, si dhe për ato të inspektimit. Në muajin nëntor të vitit 2019 është emëruar anëtare e Gjykatës Kushtetuese.




Dr. Fiona Papajorgji, anëtare

Lindur në vitin 1976 në Vlorë. Diplomuar në vitin 2000 në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Barit, Itali. Në vitin 2012 ka marrë gradën shkencore "Doktore e shkencave juridike" në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Barit. Në vitet 2000-2008 ka ushtruar profesionin e asistent avokatit dhe me pas të avokatit pranë firmave ligjore në Bari. Gjatë periudhës 2009-2011 ka punuar si juriste pranë Drejtorisë së Kërkimeve, Studimeve dhe Botimeve në Gjykatën Kushtetuese. Në vitet 2011-2019 ka ushtruar detyrën e këshilltares ligjore në Gjykatën Kushtetuese. Prej vitit 2007 e në vazhdim ushtron mësimdhënien si lektore e së Drejtës Publike në disa universitete, si dhe ka qenë eksperte në disa projekte pranë Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, në procesin e përafrimit të legjislacionit etj. Ka qenë autore e disa artikujve shkencorë në fushën e së drejtës kushtetuese. Në vitin 2019 është angazhuar nga Shkolla e Magjistraturës si pedagoge në dispozicion për vitin e parë të Programit të Formimit Fillestar. Gjatë vitit 2020 ka ushtruar funksionin e anëtares së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Në muajin nëntor të vitit 2019 është emëruar anëtare e Gjykatës Kushtetuese.




Dr. Elsa Toska, anëtare

Lindur në vitin 1976 në Kavajë. Diplomuar në vitin 2000 në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës. Në vitin 2005 ka marrë titullin "Master" në Studime Europiane në Rektoratin e Tiranës, ndërsa në vitin 2012 gradën shkencore "Doktore e shkencave juridike" në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Në vitet 2000-2006 ka punuar si ndihmëskomisionere/eksperte ligjore pranë institucionit të Avokatit të Popullit dhe në vitet 2006-2007 ka ushtruar profesionin e avokatit. Gjatë periudhës 2007-2019 ka ushtruar detyrën e këshilltares ligjore në Gjykatën Kushtetuese. Prej vitit 2005 e në vazhdim është lektore e së Drejtës Administrative dhe Kushtetuese në universitete të ndryshme, si dhe trajnere e të drejtave të njeriut brenda dhe jashtë vendit. Që nga viti 2010, është përfshirë si konsulente ligjore e jashtme në një sërë projektsh të organizmave ndërkombëtare, të lidhura me të drejtat e njeriut dhe gjyqësorin. Ka qenë pjesë e ekspertëve në 3 grupe pune gjatë Reformës në Drejtësi, përkatësisht për Amendimet Kushtetuese, Ndryshimet në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe hartimin e projektligjit për Presidentin e Republikës. Është autore e disa publikimeve shkencore në formë manualesh apo monografish, ku mund të veçohet monografia "Mbi kontrollin kushtetues të veprimtarisë administrative, sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese", si dhe bashkautore e librit "Kontrolli mbi administratën publike", 2013, tekst akademik i miratuar nga Departamenti i së Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë. Prej vitit 2017 është eksperte e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës. Është autore e disa artikujve shkencorë dhe pjesëmarrëse në disa konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit për çështje të drejtësisë kushtetuese. Në muajin nëntor të vitit 2019 është emëruar anëtare e Gjykatës Kushtetuese.



Sonila Bejtja, anëtare

Lindur në vitin 1974 në Tiranë. Në vitet 1989 - 1997 ka kryer shkollën e mesme të gjuhëve të huaja "Asim Vokshi", si dhe liceun linguistik "San Vincenzo" në Milano. Në vitin 2000 është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Milanos, Itali. Në vitet 1999 - 2004 ka ushtruar profesionin e avokatit pranë firmës ligjore "Boga & Associates". Në vitet 2004 - 2011 ka punuar si avokate dhe konsulente ligjore në disa projekte të Bankës Botërore, Bankës Italo-Shqiptare, Bankës së Kursimeve gjatë privatizimit të saj, Bankës Popullore Pulieze, Bankës Italiane për Zhvillimin, si dhe pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Radio Televizionit Shqiptar. Nga viti 2011 e në vazhdim ka ushtruar profesionin e noterit. Është anëtare e Dhomës Kombëtare të Noterëve dhe Dhomës së Noterëve Tiranë, si dhe ish-anëtare e Dhomës Kombëtare të Avokatëve. Në muajin dhjetor të vitit 2020 është emëruar anëtare e Gjykatës Kushtetuese.



Dr. Sandër Beci, anëtar

Lindur në vitin 1974 në Shkodër. Diplomuar në vitin 1996 në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër. Në vitin 2002 ka përfunduar shkollën e studimeve të thelluara pasuniversitare në fushën "Studime Evropiane" në Universitetin e Tiranës. Në vitin 2012 ka marrë gradën shkencore "Doktor i shkencave juridike" në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Në periudhën 1996-2018 ka punuar pedagog me kohë të plotë në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër. Në këtë fakultet ka ushtruar edhe funksionin e drejtorit të Departamentit Juridik; drejtorit të Departamentit të së Drejtës Civile dhe ka qenë anëtar i Komisionit të Etikës së këtij Universiteti. Është zgjedhur anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë, detyrë që e ka ushtruar për periudhën dhjetor 2018 -mars 2022. Gjatë ushtrimit të detyrës së anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është zgjedhur edhe kryetar i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, kryetar i Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit si dhe ka kryesuar komisione të përkohshme të përzgjedhjes së prokurorëve të Prokurorisë së Posaqme. Ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Është autor i disa botimeve dhe artikujve shkencorë, si dhe pjesëmarrës në disa konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit. Në muajin mars të vitit 2022 është emëruar anëtar i Gjykatës Kushtetuese.




Ilir Toska, anëtar

Lindur në vitin 1970 në Elbasan. Diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës në vitin 1992. Në vitet 2010-2011 ka kryer studimet Master i Nivelit të Dytë në Shkenca Juridike me profil e Drejta Publike, Universiteti "Marin Barleti", Tiranë. Në periudhën 1992-2001 ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë Librazhd. Në vitet 2001-2004 ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë. Prej janarit të vitit 2004 deri në prill të vitit 2007 ka ushtruar funksionin si Kryeinspektor i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në periudhën 2007-2018 ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë, ku përgjatë viteve 2012-2016 ka qenë edhe anëtar i Kolegjit Zgjedhor pranë kësaj gjykate. Në vitet 2018-2021 ka ushtruar funksionin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Gjatë periudhës dhjetor 2021-shtator 2022 ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë. Po ashtu, është angazhuar si ekspert në trajnimin vazhduar në Shkollën e Magjistraturës. Në muajin shtator të vitit 2022 është emëruar anëtar i Gjykatës Kushtetuese.



Gent Ibrahimi, anëtar

Lindur në vitin 1970, në Tiranë. Diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës, në vitin 1992. Në periudhën 1992-1993 ka kryer studime të krahasuara në të Drejtën Kushtetuese në Universitetin e Evropës Qendrore (CEU), Budapest. Rugëtimin profesional e ka nisur si pedagog i së drejtës administrative në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës. Në vitet 1994-1997, krahas punës si pedagog, ka punuar si administrator i programit të drejtësisë pranë Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. Në periudhën 1997-1999 ka ushtruar detyrën e këshilltarit ligjor dhe drejtorit të kabinetit të Ministrit të Shtetit për Reformën Legjislative dhe Marrëdhëniet me Parlamentin ku ka ndihmuar në hartimin e Kushtetutës së vitit 1998 dhe një sërë ligjesh të rëndësishme post-kushtetuese. Në vitet 2002-2003 ka ushtruar detyrën e këshilltarit të jashtëm në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale. Më tej, në vitet 2003 dhe 2006 ka shërbyer si këshilltar ligjor pranë institucioneve ndërkombëtare të qeverisjes në kuadër të UNMIK në Kosovë. Në vitet 1999-2009 ka ushtruar detyrën e drejtorit ekzekutiv në Institutin e Studimeve Publike dhe Ligjore, një organizatë jo fitimprurëse me fokus në fushën e studimeve mbi sistemin e drejtësisë dhe qeverisjen në përgjithësi. Gjatë kësaj periudhe, në harkun kohor 2009-2012, ka shërbyer si këshilltar në Projektin kundër Korrupsionit i njohur me akronimin PACA. Në vitet 2013-2014 ka qenë Kryetar i Këshillit të Reformës Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë. Më tej, në vitet 2014-2016 ka qenë Kryetar i dy prej grupeve të punës për hartimin e ndryshimeve kushtetuese e ligjore në kuadër të reformës në drejtësi. Përgjatë viteve 2019-2022 ka ushtruar detyrën e kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Prej vitit 2006 shërben si pedagog i jashtëm pranë Shkollës së Magjistraturës. Përgjatë gjithë ecurisë profesionale është angazhuar si ekspert në shërbime konsulence në fusha të tilla si sistemi gjyqësor, qeverisja, anti-korrupsioni, shërbimi civil dhe reforma administrative, media etj. Z. Ibrahimi është bashkautor i shumë studimeve dhe komentareve të botuar në fushën e të drejtave të njeriut, të drejtës kushtetuese, të drejtës administrative, sistemit të drejtësisë, lirisë së shprehjes, të drejtës të organizimit kolektiv, të drejtës të informimit, jetës private etj. Në muajin dhjetor të vitit 2022 është emëruar anëtar i Gjykatës Kushtetuese.



Prof. Dr. Marjana Semini, anëtare

Lindur në vitin 1966 në qytetin e Beratit. Diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitin 1988. Gjatë viteve 1988-1997 ka qenë pedagoge e brendshme në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës për lëndën "E Drejta e Detyrimeve dhe Kontratave". Në vitin 1993 ka marrë Gradën Shkencore "Kandidat i Shkencave në Drejtësi". Në vitin 1994 ka marrë Gradën Shkencore "Doktor në Drejtësi" dhe, më pas, në vitin 1999 ka fituar Titullin Shkencor "Profesor i Asociuar" dhe në vitin 2009 Titullin Shkencor "Profesor". Është specializuar nën Programin Fullbright (1993, Virginia School of Law, SHBA) dhe Programin TEMPUS (1993-1994, Fakulteti i Drejtësisë, Trento, Itali) etj. Në periudhën nga viti 1997 deri në vitin 2022 ka qenë pedagoge e brendshme në Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë. Në vitet 2009-2013 ka ushtruar detyrën si Drejtore e Shkollës së Magjistraturës. Ka ushtruar detyrën si përgjegjëse e Trajnimit Fillestar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shkollën e Magjistraturës deri në vitin 2022. Ka qenë anëtare e Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës për një periudhë gati 20 vjeçare. Ka qenë dhe është pedagoge e jashtme në fakultete në ndryshme të drejtësisë në Shqipëri, si dhe udhëheqëse shkencore në programe dhe shkolla doktorale në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Gjithashtu, në periudhën 2014-2020 ka qenë pedagoge e jashtme në Shkollën Kombëtare të Avokatisë. Gjatë viteve 1999-2022 ka qenë e angazhuar në programe kombëtare dhe ndërkombëtare të organizatave të Kombeve të Bashkuara (UN) të tilla si: PNUD, UNICEF, ILO, IFC, WIPO, Banka Botërore, si dhe të USAID-it, OSBE-së, Këshillit të Evropës, etj. Është aktivizuar si eksperte e pavarur që ka asistuar në Gjykatën e Arbitrazhit të Dhomës së Londrës, Zyrihut, Parisit, Vienës, etj. për çështje që lidhen me zbatimin e kontratave në fushën tregtare. Në vitet 2021-2022 ka qenë anëtare e Bordit Disiplinor të Noterisë (quasi gjykatë) pranë DHKN, si përfaqësuese e Shkollës së Magjistraturës. Gjithashtu, është autore dhe bashkautore në 37 tekste universitare, monografi, komentare, dhe mjaft artikuj shkencor dhe publikime të natyrës juridike. Në muajin dhjetor të vitit 2022 është emëruar anëtare e Gjykatës Kushtetuese.



VENDIMARRJA

ÇËSHTJE TË PËRZGJEDHURA

Konflikt i kompetencave mes pushteteve

Konflikti i kompetencave mes shumicës dhe pakicës parlamentare në rastin e konstatimit të papajtueshmërisë së mandatit të deputetit (vendim nr. 1, datë 23.01.2023 - rasti Olta Xhaçka)

Ushtrimi i së drejtës së pakicës parlamentare për të kërkuar vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit në rastet e parashikimeve të nenit 70, pika 3, të Kushtetutës, nuk është në diskrecionin e Kuvendit. Ky i fundit ka të drejtën vetëm të verifikojë kriteret formale, kurse meritën e çështjes e vlerëson Gjykata Kushtetuese. Një qëndrim i kundërt i Kuvendit përbën një rast të konfliktit të kompetencave mes shumicës dhe pakicës parlamentare.

Mbi bazën e legjislacionit në fuqi organi kompetent administrativ ka miratuar statusin “investim/investitor strategjik procedurë e asistuar” për një projekt në pronësi të bashkëshortit të deputetes së Kuvendit. Për këtë shkak, një grup deputetësh i janë drejtuar Kuvendit me mocion për ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të saj, në mbështetje të nenit 70, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës. Raportet e pakicës dhe shumicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin kanë kaluar për shqyrtim në seancë plenare në Kuvend, ku është vendosur mosmiratimi i raportit të pakicës parlamentare dhe miratimi i raportit të shumicës parlamentare. Jo më pak se një e dhjeta e deputetëve ka kërkuar në Gjykatë zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës së krijuar mes pakicës dhe shumicës parlamentare dhe deklarimin e këtyre vendimeve të Kuvendit si të papajtueshme me Kushtetutën.

Në vlerësimin e Gjykatës, sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës, Kuvendi nuk mund të vërë në diskutim mocionin e paraqitur dhe nuk mund t’ia nënshtrojë atë debatit parlamentar, por vendimarrja e tij si organ kolegjal është e domosdoshme për vënien në lëvizje të kësaj Gjykate, në mënyrë që ajo të shprehet për themelin e çështjes. Verifikimi dhe vlerësimi i kriterëve juridiko-formale të kërkesave të kësaj natyre është një çështje që i përket Kuvendit, ndërsa vlerësimi i meritës së çështjes, pra nëse me veprimet e tij deputeti ka shkelur parashikimin kushtetues të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, me pasojë konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit, është një çështje që i përket ekskluzivisht Gjykatës. Kuvendi shqyrton vetëm nëse mocioni i paraqitur ka të bëjë me papajtueshmërinë e mandatit të deputetit. Fakti që pretendimi i parashtruar në mocion nga një e dhjeta e deputetëve ose Kryetari i Kuvendit kundërshtohet nga një pjesë tjetër e deputetëve, nuk duhet të përbëjë shkak për mosmiratimin e tij.

Çështja konkrete për vlerësimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes, e cila nëpërmjet bashkëshortit mund të ketë ushtruar veprimtari fitimprurëse që burojnë nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe të ketë fituar pasuri të këtyre, nuk i takon vlerësimit të Kuvendit, por vlerësimit të kësaj Gjykate, pasi faktet kërkojnë shqyrtimin në themel, në mënyrë që të mund të përcaktohet nëse duhet të klasifikohen në parashikimet e pikës 2 ose pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës. Kuvendi duhet të kishte pranuar mocionin dhe të dërgonte çështjen për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, në mënyrë që aspektet e pretenduara si papajtueshmëri të mandatit të deputetes t’i nënshtroheshin vlerësimit kushtetues. Gjatë gjyimit kushtetues nuk u verifikua ndonjë pengesë juridiko-formale që mocioni të pengohej nga Kuvendi, ndaj vendimet e atij organi kanë cenuar të drejtën kushtetuese të një të dhjetës së deputetëve për të mos u penguar mocioni i tyre.



Konflikti i kompetencave për shkak të vendosjes së masave shtrënguese ndaj deputetit pa autorizimin e Kuvendit (vendim i Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 273, datë 20.12.2023 - rasti Sali Berisha)

Konflikti i kompetencave mund të ngrihet në Gjykatë vetëm nga subjektet në konflikt, pra subjekti që i është marrë apo është cenuar drejtpërdrejt në ndonjë kompetencë të tij. Legjitimitimi i subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve, si subjekt i pakushtëzuar, nuk vihet në diskutim në gjykimet e kontrollit kushtetues abstrakt por jo në rastet e mosmarrëveshjes së kompetencave.

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar i ka kërkuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar caktimin e masave shtrënguese “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, të parashikuara nga nenet 234 dhe 233 të Kodit të Procedurës Penale ndaj deputetit të Kuvendit, nën hetim për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë” e kryer në bashkëpunim, të parashikuar në nenet 260 dhe 25 të Kodit Penal. Këto organe nuk kanë kërkuar autorizim nga Kuvendi për caktimin e këtyre masave. Një grup prej 30 deputetësh i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet Kuvendit, nga njëra anë, dhe Prokurorisë së Posaçme e Gjykatave të Posaçme të Shkallës së Parë dhe të Apelit, duke kërkuar për këtë qëllim edhe interpretimin përfundimtar të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, si dhe konstatimin e papajftueshmërisë me Kushtetutën të këtyre masave.

Duke analizuar çështjen e legjitimitimit të kërkuarit Mbledhja e Gjyqtarëve vlerësoi se një e pesta e deputetëve dhe Kuvendi janë subjekte kushtetuese të ndryshme që nuk mund të barazohen me njëri-tjetrin. Kërkuar, në pretendimet e tij, është përqendruar në mbrojtjen e sferës së veprimtarisë së Kuvendit dhe jo të të drejtave si pakicë parlamentare, duke mos paraqitur argumente që të provojnë se është palë në konfliktin e kompetencave apo se moszgjidhja apo ekzistenca e këtij konflikti ka cenuar kompetencat e tij dhe rrjedhimisht ushtrimin e të drejtave të njohura nga Kushtetuta. Pavarësisht se është pjesë e pushtetit ligjvënës, kjo nuk nënkupton që grupi i deputetëve është subjekti kushtetues për të cilin bën fjalë neni 73, pika 2, i Kushtetutës (Kuvendi), ndaj nuk mund të veprojë në emër dhe me tagrat e këtij të fundit dhe as të barazohet me të. Në jurisprudencën kushtetuese interesi i këtij subjekti të pakushtëzuar nuk është vënë në diskutim në gjykimet e kontrollit kushtetues abstrakt, ndërsa në rastet e mosmarrëveshjes së kompetencave situata paraqitet e ndryshme, për sa kohë në këto raste duhet të ketë pozitën e subjektit në konflikt ose të cenuar drejtpërdrejt në ndonjë kompetencë të tij.

Kontroll abstrakt

Kriteret e nevojës dhe urgjencës në miratimin e akteve normative me fuqinë e ligjit për disa produkte ushqimore bazë dhe për produktet e nënproduktet e naftës dhe gazit (vendimet nr. 8, datë 22.02.2023 dhe nr. 21, datë 18.04.2023 – një grup deputetësh të Kuvendit)

Nevoja dhe urgjenca janë kriteret e vetme kushtetuese që justifikojnë në mënyrë përjashtimore ushtrimin e pushtetit legjislativ nga Këshilli i Ministrave sipas nenit 101 të Kushtetutës, analiza e të cilave duhet të gjejë vend si në relacionet që shoqërojnë aktin normativ, ashtu edhe në dokumentet që shoqërojnë miratimin e ligjeve ratifikuese. Nëse një analizë e tillë e këtyre kriterëve mungon, nuk mund të konsiderohet se janë përmbushur kërkesat e parashikuara nga neni 101 i Kushtetutës.

Edhe në drejtim të procedurës parlamentare, në komisionin përgjegjës të Kuvendit, pavarësisht se janë parashtruar disa argumente, ato janë të pamjaftueshme për të kuptuar ndikimin e situatës së krijuar në tregun kombëtar. Gjykata vlerësoi se Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi nuk kanë kryer një analizë të situatës konkrete, e cila do të justifikonte nevojën për ndërhyrje urgjente nëpërmjet akteve normative me fuqinë e ligjit dhe nuk kanë dhënë arsye se pse instrumentet ligjore dhe institucionale ekzistuese nuk janë të mjaftueshme për realizimin e qëllimit që kërkohet të arrihet për mbrojtjen e konsumatorit nga praktikat abuzive. Për rrjedhojë, këto akte u vlerësuan si në kundërshtim me nenin 101 të Kushtetutës (vendimi nr. 8, datë 22.02.2023).

Në lidhje me aktet normative me fuqinë e ligjit për produktet dhe nënproduktet e naftës e të gazit, Gjykata vuri në dukje ngjashmëritë mes çështjeve, por vlerësoi se respektimi i kriterëve kushtetuese bëhet nën dritën e rrethanave të secilit rast dhe të provave të administruara në secilin proces. Gjykata nuk vuri as në këtë rast në dyshim impaktin e konfliktit Rusi-Ukrainë në tregun e karburanteve, por theksoi veçantinë e çështjes, për shkak të impaktit që ka ndryshimi i menjëhershëm i çmimit të karburanteve në treg në të gjitha fushat e ekonomisë, tregtisë, industrisë dhe veprimtarisë prodhuese, si dhe pasojat zinxhir që sjell rritja e çmimit të këtij produkti në produktet e tjera të konsumit. Ajo vlerësoi se është arritur të vërtetohet se përpara miratimit të akteve normative ekzistonte një shkallë e madhe devijimi nga e zakonshmja për sa i përket çmimit të karburantit (nevoja), që kërkonte një ndërhyrje të menjëhershme për të parandaluar spekulimet nga ana e operatorëve që veprojnë në tregun me shumicë dhe pakicë dhe, për pasojë, për të parandaluar pasojat e dëmshme dhe të pakthyeshme për interesat e qytetarëve (urgjenca), qëllim që nuk mund të arrihej me mjete të tjera ligjore. Duke e shqyrtuar në vijim çështjen në drejtim të pretendimit për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, Gjykata vlerësoi se parashikimet e aktit normativ që e kanë lënë vlerësimin e përfundimit të situatës së veçantë në diskrecion të Bordit të Transparencës në mungesë të kriterëve të qarta, krijojnë premisa për arbitraritet, duke mos plotësuar kriterin kushtetues të kufizimit me ligj në kuptimin substancial. Kurse në lidhje me kompetencën e Bordit për vendosjen e çmimit tavan, u vlerësua se nuk sjell cenim, për sa kohë që kjo nuk bëhet mbi një vlerësim subjektiv të këtij organi, por mbi një metodologji të përcaktuar nga dispozitat ligjore, duke u lejuar individualizimi në varësi të situatës konkrete në tregun ndërkombëtar.

Gjykata e gjeti të pabazuar edhe pretendimin për cenimin e parimit të barazisë para ligjit, për shkak të formulës së përbërjes së Bordit në drejtim të përfaqësimit të shoqërive të tregimit të hidrokarbureve, për sa kohë të gjithë operatorët ekonomikë, përfshirë anëtarët e Bordit, janë subjekte të çmimit të vendosur prej tij. I pabazuar u gjet edhe pretendimi për cenimin e rregullave të Marrëveshjes së Asociim-Stabilizimit, për sa kohë që dispozitat e referuara të saj nuk gjejnë zbatim në rastin konkret.

Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin normativ me fuqinë e ligjit për përcaktimin e rregullave për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg për shkak të luftës Rusi-Ukrainë. Po kështu, Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin normativ me fuqinë e ligjit për përcaktimin e masave të veçanta që do të merren ndaj subjekteve publike ose private, vendase apo të huaja, që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre përpunimin, transportimin, tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre. Këto akte normative, ashtu si edhe shtesat/ndryshimet që i janë bërë atyre nga Këshilli i Ministrave, janë miratuar me ligj nga Kuvendi.

Jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit i është drejtuar Gjykatës me dy kërkesa të veçanta për shfuqizimin si antikushtetues të këtyre akteve normative dhe ligjeve miratuese.

Sipas Gjykatës, në analizë të nenit 101 të Kushtetutës, dhënia e pushtetit ligjvënës qeverisë ka karakter përjashtimor, prandaj ushtrimi i saj është kushtëzuar me ekzistencën e nevojës dhe urgjencës, si dhe me kontrollin përfundimtar nga Kuvendi të akteve të nxjerra. Nevoja dhe urgjenca janë përcaktuese për të drejtën që sanksionon kjo dispozitë dhe si kushte paraprake duhet të vërtetohet se kanë ekzistuar përpara marrjes të iniciativës nga qeveria. Vlerësimi i parë faktik dhe substancial i nevojës dhe urgjencës i përket Këshillit të Ministrave, dhe më pas Kuvendit, që para (mos)miratimit e shqyrton aktin normativ në formë dhe përmbajtje. Edhe pse në këtë proces Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi kanë një hapësirë të gjerë diskrecioni, kjo nuk i bën kriteret e nevojës dhe urgjencës immune nga kontrolli kushtetues.

Për sa i përket akteve normative për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, Këshilli i Ministrave e ka justifikuar nevojën dhe urgjencën me pasojat në tregun shqiptar nga ndikimi i situatës në tregun ndërkombëtar dhe lufta Rusi-Ukrainë. Gjykata nuk vuri në diskutim impaktin e luftës, në situatën që dhe një sërë shtetesh të tjera kanë ndërmarrë masa konkrete. Por ajo evidentoi se relacionet e Këshillit të Ministrave nuk përmbajnë një vlerësim të ndikimit konkret në tregun kombëtar dhe konsumatorin shqiptar nga situata e krijuar në tregun ndërkombëtar dhe efektet e luftës Rusi-Ukrainë, madje në relacionin shoqërues të aktit normativ kjo e fundit nuk përmendet si shkak urgjence.



Mosdënimi pa ligj i lidhur me kategorizimin e masave të dënimit penal me gjobë për personat juridikë (vendimi nr. 32, datë 30.05.2023 – gjykim incidental)

E drejta për të mos u dënuar pa ligj duhet të interpretohet dhe zbatohet në mënyrë që të ofrojë garanci efektive kundër ndjekjes, deklarimit fajtor dhe dënimit arbitrar. Ajo nënkupton se çdo veprë penale duhet të parashikohet me ligj dhe individit duhet të jetë objektivisht në gjendje, nëse është e nevojshme edhe me ndihmën e interpretimeve gjyqësore, të kuptojë përmbajtjen e normës penale, pra se çfarë veprimesh ose mosveprimesh do ta bëjnë atë përgjegjës penalisht. Ligjvënësi është i detyruar nga Kushtetuta të caktojë kufijtë e dënimit penal, duke respektuar kërkesat e qartësisë dhe përcaktueshmërisë së ligjit sipas parimit të sigurisë juridike. Paqartësitë e normës në rastet kur nuk krijojnë kontradiksion logjik ose pamundësi zbatimi, mund dhe duhet të zgjidhen me anë të interpretimit gjyqësor nga gjykatat e zakonshme.

Gjykata e shkallës së parë ka deklaruar personin juridik fajtor për veprat penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë” dhe “Dhënia e ndihmës për ndërtim të paligjshëm”, të parashikuara respektivisht nga nenet 289, paragrafi 1 dhe 199/b të Kodit Penal, duke e dënuar me 4,000,000 lekë gjobë, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë” të lidhur me dënimin e parashikuar për veprat penale nga Kodi Penal. Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, gjatë shqyrtimit të ankimit të paraqitur edhe nga i pandehuri personi juridik, ka vendosur pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, për të vlerësuar kushtetutshmërinë e pikës 4 të nenit 11 të ligjit nr. 9754/2007 që kategorizon masat e dënimit penal me gjobë sipas dënimeve me burgim të parashikuara nga Kodi Penal për individët.

Gjykata e shqyrtoi çështjen në drejtim të së drejtës për të mos u dënuar pa ligj, të garantuar nga neni 29 i Kushtetutës, në drejtim të aspektit substancial të saj e lidhur me cilësinë e ligjit. Në kushtet kur dënimet penale ndërhyjnë drejtpërdrejt në liritë dhe të drejtat themelore, neni 29 i Kushtetutës ia ka ngarkuar vetëm ligjvënësit miratimin abstrakt të veprave dhe dënimeve penale, i cili ka detyrimin të përshkruajë me saktësi jo vetëm elementet e figurës së veprës penale, por edhe llojin dhe masën e dënimit të saj, pra kufijtë e dënimit. Gjykata vlerësoi se pika 4 e nenit 11 të ligjit nr. 9754/2007 i kategorizon masat e dënimit penal me gjobë për personat juridikë në tre nënpika “a”, “b” dhe “c”, sipas dënimeve me burgim të parashikuara nga Kodi Penal për individët. Duke iu referuar formulimit sistematik, dispozita ka përshkallëzuar me rend zbritës masat e dënimit penal me gjobë për personat juridikë, nga ato më të rëndat te më të lehtat, i njëjti rend që përshkon edhe referencat në kufijtë e dënimeve penale të veprave sipas Kodit. Gjykata vlerësoi se përmbajtja e dispozitës së kundërshtuar nuk rezulton të ketë pasaktësi ose boshllëk ligjor dhe paqartësitë referenciale të saj janë të tilla që nuk krijojnë kontradiksion logjik ose pamundësi zbatimi, pra të passjellin papajtueshmërinë e normës me Kushtetutën. Këto paqartësi mund dhe duhet të zgjidhen me anë të interpretimit gjyqësor nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në ushtrim të rolit dhe funksionit të tyre kushtetues të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ndaj nuk rezulton që të mos jetë përmbushur aspekti substancial i cilësisë së ligjit.

VKM-ja për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje për qëllim fitimi (vendimi nr. 35, datë 15.06.2023 - një grup deputetësh të Kuvendit)

Koncepti kushtetues rezervë ligjore krijon mundësinë që çështja konkrete e rregulluar pjesërisht me ligj të mund të detajohet më tej nga aktet nënligjore, duke iu përmbajtur parimeve dhe kufijve të përcaktuar prej tij. Rezerva ligjore cenohet kur ligji nuk ka bërë asnjë delegim tek ekzekutivi për të rregulluar një çështje konkrete ose kur ekzekutivi ka rregulluar çështje të tjera nga ato që i ka deleguar ligjvënësi. E drejta e parablerjes e parashikuar nga VKM-ja është një instrument i parashikuar për të realizuar procedurën e konfiskimit për interes publik në kuadër të delegimit të ligjit. Edhe nëse ky akt nuk do e parashikonte në mënyrë të shprehur këtë të drejtë, ajo, gjithsesi, do të gjente zbatim sipas përcaktimeve të Kodit Civil.

Vendimi i Këshilli i Ministrave nr. 589, datë 07.09.2022 "Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi" është kundërshtuar në Gjykatë nga jo më pak se një e pesta e deputetëve, me argumentin se bie ndesh me disa parime dhe të drejta kushtetuese.

Në drejtim të pretendimit për cenimin e hierarkisë së akteve normative dhe të rezervës ligjore, Gjykata arriti në përfundimin se akti i kundërshtuar ka dalë në bazë të autorizimit të dhënë nga ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit". VKM-ja ka përcaktuar rregullat konkrete që duhet të zbatohen gjatë konfiskimit dhe ka detajuar procedurën administrative, ndërkohë që mënyra e kalimit të pronësisë për ndërtimet që tejkalojnë masën e lejes së ndërtimit dhe që është e pamundur të prishen, është parashikuar nga neni 52, pika 1, i ligjit. Në përmbajtje të VKM-së nuk konstatohen rregulla për përjashtimin nga përgjegjësia penale të subjekteve që kanë ndërtuar pa leje ose në tejkallim të lejes së ndërtimit, apo amnistinë e tyre, por parashikimet e saj rregullojnë pasojat civile të kundërvajtjes administrative. E drejta e parablerjes e parashikuar nga VKM-ja është një instrument për të realizuar procedurën e konfiskimit për interes publik në kuadër të delegimit të nenit 52 të ligjit nr. 107/2014. Por edhe nëse VKM-ja nr. 589/2022 nuk do parashikonte në mënyrë të shprehur këtë të drejtë, ajo, gjithsesi, do të gjente zbatim sipas përcaktimeve të Kodit Civil.

Në drejtim të pretendimit për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, Gjykata vlerësoi se pavarësisht se VKM-ja nr. 589/2022 ka njohur të drejtën e parablerjes për subjektin që ka ndërtuar pa leje ose në tejkallim të saj, kjo nuk përbën diferencim midis subjekteve që ushtrojnë këtë të drejtë dhe atyre që nuk e ushtrojnë. Në rast të ndërtimeve pa leje ose në tejkallim të saj, gjithmonë subjektet do t'i nënshtrohen procedurës së konfiskimit të pasurisë nga ana e shtetit, pasi janë në të njëjtat kushte paligjshmërie dhe ndërtimi i paligjshëm do të bëhet pronë shtetërore dhe nëse ato do t'i transferohen për shkak të së drejtës së parablerjes subjektit zhvillues, shteti do të përfitojë vlerën e sendit sipas çmimit të tregut.

Për pretendimin për të drejtën e pronës private, Gjykata vlerësoi se edhe pse VKM-ja ka parashikuar pasojat që vijnë për pronarët e truallit ose personat e tretë që kanë blerë në mënyrë të ligjshme dhe në mirëbesim, kjo nuk do të thotë se atyre u është cenuar kjo e drejtë. Ata kanë në dispozicion mjetet e mbrojtjes së të drejtave të tyre sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë edhe mbrojtjen gjyqësore. I pabazuar u gjet edhe pretendimi për të drejtën për proces të rregullt, pasi akti i kundërshtuar ka parashikuar në mënyrë të shprehur njoftimin e individit për vendimin e konfiskimit dhe nuk përmban ndonjë ndalim të shprehur për të drejtën për të ankimuar masën e konfiskimit apo për të ngritur padi në gjykatë.



**Shqyrtimi i marrëveshjeve
ndërkombëtare pas ratifikimit (vendimi
nr. 36, datë 16.06.2023 – Porti i
Durrësit)**

Statusi i marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar nuk barazohet me atë të ligjit ratifikues. Ato janë akte juridike të mëvetshme. Juridiksioni kushtetues përfshin kontrollin kushtetues të marrëveshjes ndërkombëtare vetëm para ratifikimit dhe jo pasi është bërë pjesë e rendit të brendshëm juridik. Ligji ratifikues, megjithatë, nuk përjashtohet nga kontrolli kushtetues, i cili ushtrohet vetëm në aspektin formal, pra në drejtim të procedurës parlamentare për miratimin e tij.

Në datën 26.11.2020 mes përfaqësuesve të qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe është nënshkruar marrëveshja për bashkëpunim ekonomik ndërmjet dy vendeve, e cila është ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr. 145/2020, datë 03.12.2020. Në bazë të këtyre akteve dhe legjislacionit në fuqi janë miratuar edhe një sërë aktesh nënligjore. Një grup deputetësh të Kuvendit kanë kërkuar nga Gjykata shfuqizimin e këtij ligji si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Gjykata vërejt se në rendin tonë juridik marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi, nuk janë të renditura në të njëjtin nivel me ligjet dhe janë përcaktuar madje si kritere të kontrollit kushtetues të tyre. Ligji ratifikues përmban vetëm një nen, ku shprehet për marrëveshjen që ratifikon dhe hyrjen e saj në fuqi, ndërkohë që teksti i marrëveshjes i bashkëlidhet dhe bëhet pjesë përbërëse e tij. Statusi i marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar nuk barazohet me atë të aktit juridik që i jep efektivitet në rendin e brendshëm ligjor. Për sa kohë që marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nuk barazohen me ligjet e zakonshme, edhe vetë ligji ratifikues është një akt juridik i mëvetshëm. Gjykata vlerësoi se neni 131, pika 1, shkronja “b” dhe neni 180 i Kushtetutës nuk i njohin asaj në mënyrë të shprehur dhe të drejtpërdrejtë kompetencën për të vendosur për kushtetutshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare pas ratifikimit, pra pasi ato bëhen pjesë e rendit të brendshëm juridik. Duke qenë se në momentin e paraqitjes së kërkesës kushtetuese kishte hyrë në fuqi ligji ratifikues, ky fakt juridik pamundësonte kontrollin kushtetues të Marrëveshjes. Gjatë procedurës parlamentare deputetët kanë të drejtën të iniciojnë kontrollin paraprak të marrëveshjeve ndërkombëtare, ndërkohë që mospërdorimi i këtyre mjeteve në mënyrën dhe kohën e duhur nuk mund të përbëjë shkak për zgjerimin e juridiksionit kushtetues.

Megjithatë, kjo nuk përjashton nga kontrolli kushtetues ligjin ratifikues, ashtu si çdo ligj tjetër, por ky kontroll ushtrohet vetëm në aspektin formal, pra në drejtim të procedurës parlamentare për miratimin e tij. Në drejtim të kësaj procedure, Gjykata arriti në përfundimin se ligji është miratuar në përputhje me parashikimet që përcaktojnë kuorumin dhe shumicën e nevojshme të votave për vendimarrje.

Kriteret ligjore për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse (vendimi nr. 62, datë 20.11.2023 - ligji për OJF-të)

Aftësia për të formuar një person juridik, si një nga aspektet e rëndësishme të lirisë së organizimit, lidhet me krijimin e kushteve që lejojnë dhe lehtësojnë regjistrimin dhe ushtrimin e veprimtarisë. Parashikimet ligjore që përcaktojnë detyrime për këto subjekte, veçanërisht kur bëhet fjalë për masa që shoqërohen me pasoja financiare, nuk duhet të krijojnë një barrë të tepruar dhe as të sjellin efekte frenuese në drejtim të formalizimit të grupimeve joformale dhe regjistrimit të tyre, çka mund të rezultojë de facto në pamundësinë për të fituar personalitet juridik.

Ligji nr. 80/2021, datë 24.06.2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", që përcakton procedurat e regjistrimit dhe rregullat për mbajtjen e regjistrit për organizatat jofitimprurëse, është kundërshtuar në Gjykatë nga disa organizata, mbi pretendimin se dispozita të tij cenojnë lirinë kushtetuese të organizimit, të parashikuar nga neni 46 i Kushtetutës.

Gjykata vlerësoi se neni 8 i ligjit nr. 80/2021 që parashikon detyrimin për regjistrim fillestar brenda një afati 30-ditor, jo vetëm që i detyron qytetarët të regjistrohen në gjykatë pavarësisht vullnetit të tyre, por rezultojnë të jenë edhe një detyrim i ri, i krijuar prej tij. Efekti i këtij detyrimi sjell një "efekt frenues" në zgjedhjen e grupimeve për t'u formalizuar dhe regjistruar sipas ligjit, çka mund të rezultojë de facto në pamundësinë e tyre për të fituar personalitet juridik. Përmbajtja e dispozitës nuk plotëson kriterin e "cilësisë së ligjit" të kërkuar nga neni 17 i Kushtetutës dhe parimi i sigurisë juridike, si dhe është një masë që i nuk përgjigjet një nevojë urgjente dhe në përpjesëtim me qëllimin që kërkohet të arrihet.

Edhe dispozitat që parashikojnë kompetencën e kancelarit për regjistrimet e tjera u konsideruan në kundërshtim me nenin 46 të Kushtetutës, që në mënyrë të qartë ka parashikuar gjykatën si organin kompetent që vendos për regjistrimin. Çështjet që kanë të bëjnë me regjistrimin e OJF-ve, për shkak të natyrës dhe pasojave të tyre, nuk përfshihen në konceptin e çështjeve jogyqësore ose administrative, pra në fushën e kompetencave të menaxhimit dhe administrimit gjyqësor që i përket kancelarit sipas ligjit. Gjykata shfuqizoi si jokushtetuese edhe parashikimet e nenit 49 që përcaktojnë masën e gjobës për kundërvajtjet administrative, pasi vlerësoi se nuk respektojnë kriterin e proporcionalitetit të ndërhyrjes. Marzhi i përcaktuar nga 0.1% deri në 1%, nuk plotëson standardet lidhur me qartësinë e normës juridike për sa i përket kuptimit dhe përlllogaritjes së gjobave mbi të ardhurat vjetore të deklaruara të organizatave jofitimprurëse, duke i bërë këto ndëshkime për nga natyra e tyre arbitrare. Përcaktimi i gjobës në masën minimale prej 30.000 lekësh konsiderohet si një masë joproporcionale në lidhje me synimin që kërkohet të arrihet. Gjykata vlerësoi se subjektet e interesuara nuk paraqitën arsye dhe argumente për të justifikuar vendosjen e këtyre masave për shkelje të këtij lloji dhe natyre dhe as ndikimin dhe efektet e tyre në aftësinë e OJF-ve për të ushtruar veprimtarinë e tyre për qëllime të ligjshme.

Për dispozitat e tjera të këtij ligji, Gjykata vendosi se pretendimet e kërkuarve janë të pabazuara, pasi nuk u provuan pasojat në ushtrimin e lirisë kushtetuese të organizimit.



E drejta e disponimit me testament sipas nenit 377 të Kodit Civil (vendimi nr. 69, datë 27.12.2023 – gjykim incidental)

Rregullat e nenit 377 të Kodit Civil që përcaktojnë kategorinë e rrethit të trashëgimtarëve testamentarë kufizojnë në thelb të drejtën e trashëgimlënësit për të disponuar sipas vullnetit të tij pronën pas vdekjes. Mosparashikimi i mundësisë së disponimit të pasurisë me testament për bashkëshortin pasjetues, i cili duhet të ketë një vend në rrethin e trashëgimtarëve testamentarë të barabartë me atë të fëmijëve, ashtu edhe mungesa e një kuote në dispozicion të trashëgimlënësit, për ta disponuar sipas vullnetit të tij ose në çfarëdo forme, përbën boshllëk ligjor.

Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, kanë pezulluar çështjet civile në shqyrtim dhe i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 377 të Kodit Civil, që parashikon se trashëgimlënësi që nuk lë të paslindur ose të paralindur, ose vëllezër apo motra ka të drejtë të disponojë me testament pasurinë në favor të çdo personi fizik ose juridik.

Gjykata e shqyrtoi çështjen në drejtim të së drejtës së pronës private të lidhur me parimin e sigurisë juridike dhe vlerësoi se neni 377 i Kodit Civil kufizon të drejtën e trashëgimlënësit për të disponuar sipas vullnetit të tij pronën pas vdekjes. Duke analizuar kriteret kushtetuese të ndërhyrjes sipas nenit 17 të Kushtetutës, Gjykata vlerësoi se kjo dispozitë synon të mbrojtë rrethin e ngushtë familjar dhe ka për qëllim garantimin e rendit juridik dhe stabilitetit të marrëdhënieve juridike në shoqëri, ndaj ndërhyrja i përgjigjet interesit publik. Kurse në lidhje me kriterin e proporcionalitetit, Gjykata vlerësoi se ligjvënësi, edhe pse e ka përfshirë bashkëshortin pasjetues në nenin 361 të Kodit Civil si trashëgimtar ligjor të radhës së parë, nuk e ka parashikuar atë në rrethin e trashëgimtarëve testamentarë, pavarësisht pozicionit të veçantë që ka ai në marrëdhëniet familjare. Për këtë arsye, pamundësia e disponimit të pasurisë me testament për bashkëshortin pasjetues vjen në kundërshtim me qëllimin e ligjvënësit. Mbrojtja e së drejtës për të disponuar pronën me testament mund të arrihet nëpërmjet parashikimit të një kuote në dispozicion të trashëgimlënësit, të cilën mund ta disponojë sipas vullnetit të tij ose në çfarëdo forme që ligjvënësi e sheh të përshtatshme. Mungesa e këtyre parashikimeve përbën një masë të padrejtë dhe të bazuar mbi vlerësime alogjike, ndaj kufizimi i vendosur nuk është proporcional. Neni 377 i Kodit Civil përmban boshllëk ligjor, i cili duhet të plotësohet nga ligjvënësi brenda një viti nga hyrja në fuqi e vendimit. Ligjvënësi duhet, gjithashtu, të rishikojë kreun që lidhet me institutin e trashëgimisë testamentare në Kodin Civil, me frymën e Kushtetutës dhe në linjë me parashikimet e Kodit të Familjes dhe vendimin e Gjykatës.

Riorganizimi i rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave (vendimi nr. 70, datë 27.12.2023 - Harta Gjyqësore)

Riorganizimi i rretheve gjyqësore, duke ulur numrin e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe atij administrativ të shkallës së parë dhe duke shkrirë gjykatat e apelit në një të vetme, është një masë që sjell pasoja të drejtpërdrejta në liritë dhe të drejtat themelore. Megjithatë, kjo masë plotëson kriteret e ndërhyrjes në drejtim të kufizimit vetëm me ligj dhe të interesit publik, si dhe është një masë proporcionale, për sa kohë që është respektuar baraspeshimi i ndërhyrjes me gjendjen që e ka diktuar atë.

Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit i kanë kërkuar Gjykatës shfuqizimin si jokushtetues të VKM-së nr. 495, datë 21.07.2022 "Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave".

Gjykata konstatoi se harta gjyqësore ka sjellë uljen më të thellë të numrit të gjykatave në vitet e fundit. Efektet e saj prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë ushtrimin e veprimtarisë nga ana e avokatëve, pavarësisht mënyrës se si janë organizuar ata në dhomat vendore të avokatisë dhe, po ashtu, të drejtën e aksesit në gjykatë. Megjithatë, Gjykata vlerësoi se kjo ndërhyrje është bërë në përputhje me kriteret e kufizimit sipas neneve 11 dhe 17 të Kushtetutës. VKM-ja është miratuar në përputhje me delegimin ligjor dhe për të bërë të zbatueshme parashikimet e ligjit nr. 98/2016. Në drejtim të interesit publik që justifikon ndërhyrjen, ai qëndron në rritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë si dhe cilësisë së gjykimeve, ashtu edhe garantimin e afateve të arsyeshme për zhvillimin e proceseve gjyqësore. Në lidhje me parimin e proporcionalitetit në kufizimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike u vlerësua se pavarësisht pasojave në drejtim të rritjes së kostove dhe shpenzimeve, ato nuk janë të tilla që të vendosin një barrë të tepruar e të papërballueshme për avokatët dhe nuk e bëjnë të pamundur ushtrimin e profesionit prej tyre. Për sa i përket së drejtës së aksesit u vlerësua se masa është e përshtatshme për të siguruar objektivat dhe qëllimin e synuar dhe e domosdoshme, për sa kohë që është provuar se asnjë masë tjetër nuk ishte e aftë të zgjidhte situatën. Në balancimin e interesave është respektuar interesi domethënës i së mirës së përgjithshme, nga njëra anë, me kufizimin e së drejtës së aksesit, nga ana tjetër. Individët kanë mundësinë të ushtrojnë të drejtën kushtetuese të aksesit në gjykatë, pavarësisht efekteve të riorganizimit gjyqësor, të cilat, në thelb, nuk e kanë bërë të pamundur atë.

Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë para ligjit, Gjykata vlerësoi se edhe pse akti i kundërshtuar ka sjellë një diferencim mes avokatëve, në rastin konkret ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive sipas nenit 18 të Kushtetutës.

Ankim kushtetues individual

Të drejta procedurale

Çështjet e ligjit të vëna në shqyrtim kryesisht nga Gjykata e Lartë (vendim nr. 7, datë 21.02.2023 - kërkuar Aleksandër Dhima)

Kur Gjykata e Lartë vë në diskutim çështje të ligjit kryesisht, siç janë kushtet ligjore për paraqitjen e padisë, të cilat nuk janë ngritur nga palët në rekurs dhe për të cilat nuk kanë dhënë mendim, ajo duhet t'i njoftojë ato, duke caktuar afatin për depozitimin e parashtimeve, ose të shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve kur vlerëson se është problematike ose komplekse.

Kërkuesi ka qenë oficer i shërbimit aktiv në Forcat e Armatosura. Pasi ka dalë në rezervë, për shkak të reformës, ai është trajtuar me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, i cili është ndërprerë për shkak të punësimit në sektorin publik. Me hyrjen në fuqi të ligjit të vitit 2009, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore i ka ricaktuar pensionin e parakohshëm, duke mos i njohur të drejtën për një periudhë kohore para hyrjes së tij në fuqi. Mbi padinë e kërkuesit gjykatat e zakonshme kanë vendosur njohjen e së drejtës edhe për këtë periudhë, ndërsa Gjykata e Lartë ka prishur vendimet dhe ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes. Sipas saj, kërkuesi, në kohën kur i është ndërprerë pensioni i parakohshëm nuk ka ushtruar ankim, ndaj nuk mund të kërkojë gjyqësisht një të drejtë pa ezauruar më parë ankimin administrativ. Po kështu, padia nuk është ushtruar brenda afatit ligjor 3-vjeçar të parashikuar nga ligji i kohës. Kërkuesi ka pretenduar në ankimin kushtetues cenimin e së drejtës së aksesit.

Gjykata vërejtë se kushtet formale për ngritjen e padisë, referuar natyrës dhe rëndësisë së tyre, janë të verifikueshme nga gjykata edhe kryesisht, pa pasur nevojë për kërkesë paraprake nga palët. Për shkak të këtyre karakteristikave ky verifikim përbën çështje me natyrë ligjore. Çështja e shterimit të ankimit administrativ dhe afati i ngritjes së padisë nuk janë paraqitur si shkaqe në rekurs nga pala tjetër, çka do të thotë se janë verifikuar si çështje ligjore për herë të parë dhe me nismë të vetë Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit. Kërkuesit nuk i është dhënë mundësia të paraqesë paraprakisht mendimin e tij për çështjet ligjore të analizuar nga Gjykata e Lartë, duke u vendosur në pamundësi për t'u mbrojtur efektivisht për to. Për rrjedhojë, vendimi gjyqësor nuk i ka dhënë përgjigje përfundimtare pretendimit për të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi.

Njoftimi i aktit të shpronësimit për interes publik (vendim nr. 16, datë 23.03.2023 - kërkuese Drita Shpendi)

E drejta e pronës private është e garantuar nëse në rastet e shpronësimit shteti merr përsipër të respektojë kufizimin në përmbushje të një interesi publik, kundrejt një shpërblimi të drejtë dhe në respektim të së drejtës së ankimit për masën e shpërblimit. Rrëzimi i padisë nga gjykata e apelit si e paraqitur jashtë afatit, duke e lidhur këtë afat me momentin e paraqitjes së kërkesës për saktësimin e objektit të padisë dhe duke e konsideruar atë padi të re, lidhet me të drejtën për të marrë përgjigje përfundimtare për kërkimet e paraqitura në objektin e padisë. Gjykata e Lartë në përputhje me parimin e subsidiaritetit dhe si gjykatë ligji, duhet të arsyetojë, qoftë edhe minimalisht, kur pretendimet e ngritura në rekurs kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit, veçanërisht kur kjo lidhet me të drejta kushtetuese substanciale të individit.

Kërkuësja, pronare e një pasurie të paluajtshme e llojit truall, është shpronësuar për interes publik, me vendim të Këshillit të Ministrave, me qëllim ndërtimin e një segmenti rrugor që prekte edhe pronën e saj. Vendimi ka parashikuar edhe masën e shpërblimit, me të cilën ajo nuk ka qenë dakord, ndaj e ka kundërshtuar në gjykatë. Gjatë veprimeve përgatitore, kërkuësja (paditëse) ka paraqitur kërkesë për saktësimin e objektit të padisë, duke kërkuar edhe anulimin e pjesshëm të VKM-ve lidhur me masën e shpërblimit, e cila është pranuar nga gjykata. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në themel, por është shprehur se është paraqitur brenda afatit ligjor. Gjykata e apelit, ka lënë në fuqi vendimin me arsyetim të ndryshëm, duke vënë në diskutim kryesisht afatin e paraqitjes së padisë. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit. Vendimet e gjykatave janë kundërshtuar në ankimin kushtetues, me pretendimin se gjykatat kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi në asnjë shkallë të gjyimit nuk është provuar se ajo është njoftuar për shpronësimin dhe vlerën e tij.

Gjykata e ka shqyrtuar çështjen në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit. Thelbi i procesit lidhet me të drejtën e kërkuësës për të kërkuar shpërblim të drejtë për shpronësimin për interes publik të pasurive të saj, nëpërmjet ankimit në gjykatë të masës së shpërblimit. Gjykata e apelit e ka konsideruar padinë të paraqitur jashtë afatit. Ajo ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga gjykata e shkallës së parë, e cila e ka konsideruar padinë të paraqitur në afat, për sa kohë për kërkuësen nuk ka pasur njoftim të drejtpërdrejtë për aktin e shpronësimit. Gjykata e apelit ka vlerësuar se kundërshtimi i masës së shpërblimit është i lidhur me VKM-të që kanë përcaktuar shpronësimin dhe shpërblimin e pronarit të shpronësuar dhe duke e konsideruar kërkesën për saktësimin e objektit të kërkesëpadisë si shtesë të objektit, pra si kërkim të ri, ka vlerësuar se padia është paraqitur jashtë afatit ligjor nga dita e botimit të këtyre akteve në Fletoret Zyrtare. Si pasojë e këtij interpretimi, kërkuësja nuk ka marrë përgjigje përfundimtare për pretendimet për thelbin e padisë, që kanë të bëjnë me masën e shpërblimit nga shpronësimi. Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji dhe në ushtrim të funksionit subsidiar, duhej të shprehej në lidhje me këtë qëndrim.



Kufizimi i së drejtës së ushtrimit të profesionit për interes publik (magjistratura) (vendim nr. 17, datë 23.03.2023 - kërkues Shiqiri Manjani)

Për shkak të natyrës së funksionit që kryen në shoqëri, integriteti i magjistratit është një domosdoshmëri, sepse besimi i publikut tek institucionet e drejtësisë nuk varet vetëm nga profesionalizimi i tyre, por edhe nga integriteti moral. Magjistrati ose kandidati për magjistrat, i cili është subjekt që së shpejti pritet të jetë pjesë e sistemit të drejtësisë, duhet kurdoherë që të sillet me nder dhe të jetë i virtytshëm që të kontribuojë në rritjen e besimit të qytetarëve tek sistemi, profesionistët e sistemit të drejtësisë dhe të jetë në gjendje që të ofrojë besueshmëri. Kalimi me sukses i provimit të pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës nuk nënkupton domosdoshmërisht fitimin e së drejtës së ushtrimit të profesionit. Kjo është e ndërvarur nga përfundimi me sukses i programit, kalimi me sukses i proceseve të tjera ligjore deri në emërimin dhe fitimin e statusit të magjistratit.

Kërkuesi ka marrë pjesë në provimin për pranimin në programin e formimit fillestar të zhvilluar nga Shkolla e Magjistraturës, profili prokuror, dhe është shpallur fitues, duke iu nënshtruar procesit të verifikimit të figurës dhe të pasurisë. Në formularin e vetëdeklarimit të plotësuar prej tij në kuadër të kësaj procedure, ai ka pasqyruar se është dënuar me burgim për kryerjen e veprës penale "Vjedhja", e parashikuar nga Kodi Penal. Duke konsideruar se ky fakt përbën shkak pengues sipas ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vendosur ndalimin e kandidimit të kërkuesit. Gjykatat e zakonshme kanë vendosur rrëzimin e padisë së kërkuesit për kundërshtimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual, duke pretenduar se nuk është thirrur e dëgjuar gjatë procedurës administrative, se vepra penale është kryer kur ka qenë i mitur dhe se ai është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal dhe se është mbajtur qëndrim i ndryshëm në raste të ngjashme.

Gjykata, në lidhje me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për mbrojtje efektive për procesin e zhvilluar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, ka vlerësuar se procesi administrativ është realizuar mbi bazë të dokumenteve, që i janë bërë të ditura rregullisht kërkuesit dhe ai ka paraqitur pretendimet e tij në lidhje me shkaktuesit përjashtues. Gjykata e ka gjetur të pabazuar edhe pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit, duke vlerësuar se vendimet plotësojnë standardet kushtetuese dhe nuk rezultojnë të jenë të paqarta, alogjike ose në mungesë të elementeve formale. Për cenimin e parimit të barazisë para ligjit, Gjykata konstatoi se specifikat e çështjes së kërkuesit dhe asaj të një kandidatje tjetër janë të ndryshme, pavarësisht se janë marrë nga i njëjti trup gjykues i Gjykatës së Lartë. Në rastin e kërkuesit, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se "Vjedhja" përbën një vepër të rëndë penale, e cila realizohet me dashje, të tillë që diskrediton figurën e funksionarit publik, për më tepër kur i atribuohet figurës së një gjyqtari ose prokurori. Ndërsa në rastin e kandidatës tjetër, e dënuar për veprën penale "Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt", është vlerësuar se për nga efekti, mënyra e kryerjes dhe pasojat, nuk reflekton elemente të një sjelljeje diskredituese të funksionit shtetëror, që mund të përbëjë rrezik për cenimin e interesave shtetërore.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet për cenimin e parimit të sigurisë juridike, në lidhje me faktin se kërkuesi është rehabilituar sipas ligjit, duke arritur në përfundimin se ekzistenca e një vendimi dënimi të formës së prerë konsiderohet kriter ndalues dhe ligji nr. 96/2016 nuk e lidh atë me mënyrën se si është ekzekutuar dënimi ose ndryshimet në pasojat që sjell një masë dënimi e përcaktuar si pasojë e deklarimit fajtor të të pandehurit. Ky kufizim është në funksion të garantimit të integritetit, qenësor për veprimtarinë e mirëfilltë të një magjistrati. Për pretendimin për cenimin e së drejtës për akses në funksione publike, së drejtës për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme dhe së drejtës për jetë private të lidhur me parimin e proporcionalitetit, Gjykata vlerësoi se, duke pasur parasysh se ligji nr. 96/2016 ka për qëllim edhe garantimin e integritetit të një kategorie të caktuar të funksionarëve publikë, është në përputhje me frymën e procesit të verifikimit të pasurisë dhe pastërtisë së figurës së kandidatëve për magjistratë, që të ketë një shkallë kufizimi për pranimin e tyre në Shkollën e Magjistraturës, në rast të mospërmbyesjes së një prej kriteve ligjore të përcaktuara.

Shkaku ligjor i vendimarrjes së ndalimit të kërkuesit nga kandidimi për në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës nuk bie ndesh me frymën e ligjit dhe interpretimi i ligjit sipas KLP-së dhe gjykatave të zakonshme nuk duket arbitrar në kuptimin kushtetues. Kurse për pretendimet për cenimin e së drejtës për jetë private, për shkak të pamundësisë së ushtrimit të profesionit të prokurorit, kërkuesi nuk ka arritur të parashtojë argumente kushtetuese. Kalimi me sukses i provimit të pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës nuk nënkupton domosdoshmërisht fitimin e së drejtës së ushtrimit të profesionit të magjistratit, pasi një gjë e tillë është e ndërvarur nga përfundimi me sukses i këtij programi, sikundër edhe nga suksesi i kalimit të proceseve të tjera ligjore deri në emërimin dhe fitimin e statusit të magjistratit.

**Rivendosja në afat e së drejtës së ankimit
për vendimin e njohjes së vendimit
të huaj penal (vendim nr. 30, datë
29.05.2023 - kërkuar Vladimir Mnela)**

Është detyrë e gjykatave të zakonshme të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor, ndërsa detyra e Gjykatës Kushtetuese është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar.

Mbi bazën e kërkesës së prokurorisë gjykatat e zakonshme kanë pranuar kërkesën për njohjen e vendimeve penale të formës së prerë të gjykatave italiane, që kanë dënuar kërkuar me 30 vite burgim për kryerjen e disa veprave penale. Në konvertim të dënimit atij i është caktuar një dënim i vetëm me 30 vjet burgim. Vendimi është dhënë në mungesë të kërkuar dhe ka marrë formë të prerë pasi nuk është paraqitur ankim. Kërkuar ka paraqitur kërkesë për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit, që nuk është pranuar nga gjykatat pasi nuk është shoqëruar me ankimin kundër vendimit për të cilin kërkohej kjo rivendosje në afat, sipas parashikimeve të nenit 420/1, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale. Në ankimin kushtetues individual kërkuar ka pretenduar cenimin e standardit të arsyetimit, për shkak të mënyrës së interpretimit të dispozitave procedurale nga gjykatat.

Sipas Gjykatës, dispozita procedurale, në mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit nga gjykatat, plotëson kriterin e qartësisë dhe parashikueshmërisë, ndaj kërkuar, përmes përfaqësuesit ligjor, duhet të ishte i qartë paraprakisht për plotësimin e kushteve ligjore, konkretisht për detyrimin për t' i bashkëlidhur kërkesës aktin e kërkuar, sipas formës dhe mënyrës së parashikuar nga ligji. Duke vlerësuar rëndësinë e administrimit të mirë të drejtësisë, në kuadër të interesit publik dhe në respektim të së drejtës për akses substancial, interpretimi i bërë nga gjykatat për nenin 420/1 të Kodit të Procedurës Penale nuk është arbitrar.



**Mungesa e qëndrimit të Gjykatës së
Lartë në lidhje me kuptimin e drejtë
të normës ligjore (vendim nr. 41, datë
18.09.2023 - kërkues Dritan Xhixha)**

Ndonëse gjykatat e shkallëve më të ulëta kanë pasur këndvështrime të ndryshme për sa i përket interpretimit dhe zbatimit të ligjit që rregullon marrëdhënien mes palëve, Gjykata e Lartë, si gjykatë e ligjit, që i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të ushtruar rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, nuk ka ndikuar efektivisht në vendimarrjen e tyre, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve që kanë formuar thelbin e mosmarrëveshjes objekt gjykimi.

Gjatë marrëdhënies së punës në Policinë e Shtetit, kërkuesi, në zbatim të detyrimeve të ligjit të dekriminalizimit, ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit, si dhe ka depozituar shenjat daktiloskopike. Mbi bazën e informacionit të Institutit të Policisë Shkencore, sipas të cilit kërkuesi kishte në bazën e të dhënave një kartelë daktiloskopike, ndaj tij ka filluar hetimi disiplinor. Sipas informacionit të Drejtorisë së Analizës së Informacionit Kriminal kërkuesi figuronte i regjistruar si person me precedent kriminal nga strukturat e hetimit të krimit. Në përfundim të hetimit disiplinor ndaj kërkuesit është marrë masa disiplinore "Përgjashtim nga policia" dhe është urdhëruar përgjashtimi nga Policia e Shtetit për "Pavlefshmëri të aktit administrativ të pranimit". Gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e padisë, duke arsyetuar se kërkuesi nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, duke mos pasqyruar të dhënat në rubrikën nr. 4 të këtij formulari. Fakti që kërkuesi nuk mban mend situatën konkrete për të cilën është shoqëruar në polici, nuk e përjashton nga përgjegjësia në deklarimin e saktë të të dhënave. Vendimi është ndryshuar nga gjykata administrative e apelit, që ka shfuqizuar urdhrin e përjashtimit nga Policia e Shtetit dhe rikthimin e kërkuesit në detyrën e mëparshme. Sipas saj ligji ka parashikuar rastet kur punonjësi i policisë lirohet nga detyra dhe ato që motivojnë përjashtimin nga Policia e Shtetit, si dhe pasojat për secilin rast, të cilat janë të ndryshme. Përjashtimi i kërkuesit është bërë për motivin "Pavlefshmëri e aktit administrativ të pranimit", në zbatim të dispozitave që rregullojnë rastet e lirimit dhe jo të përjashtimit. Kërkuesi ka plotësuar formularin përkatës, ndërkohë që e dhëna për daktiloskopimin e tij në vitin 1989 nuk përfshihet në asnjë nga situatat që ky ligj ka përcaktuar në mënyrë shteruese. Për kërkuesin nuk ka asnjë akt që provon ekzistencën e të dhënave sipas kushteve të ndalimit që ligji parashikon. Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke e konsideruar arsyetimin dhe përfundimin e gjykatës së apelit rrjedhojë të interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit material e procedural. Kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual kundër këtij vendimi.

Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit, Gjykata vlerësoi se mungesa e njoftimit në adresën elektronike të avokates së kërkuesit përbën mangësi në drejtim të njoftimit. Megjithatë, kërkuesi nuk është vendosur në pozita të pafavorshme lidhur me të drejtën e aksesit në aspektin substancial. Ai është njoftuar rregullisht për rekursin e palës tjetër, ka paraqitur kundërrekurs, dhe njoftimi për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues ka qenë i afishuar nga Gjykata e Lartë si në këndin e njoftimeve në ambientet fizike, ashtu edhe në faqen elektronike të saj.

Në ankimin kushtetues kërkuesi nuk ka evidentuar se ka pasur ndonjë argument thelbësor të ri të paparashtruar më parë, i cili potencialisht mund ta kishte bindur Gjykatën e Lartë që të ndryshonte mënyrën e zgjidhjes së çështjes së tij. I pabazuar është gjetur edhe pretendimi për parimin e paanshmërisë për shkak të pjesëmarrjes në trupin gjykues që ka shqyrtuar rekursin të gjyqtarëve që kanë shqyrtuar kërkesën për pezullim, për sa kohë që vendimet kanë të bëjnë me kërkesa që kanë karakteristika të dallueshme dhe që bazohen në konsiderata e vlerësime të ndryshme të gjyqtarëve.

Gjykata ka gjetur, në vijim, të bazuar pretendimin për standardin e arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë. Pavarësisht se ecuria disiplinore ndaj kërkuesit ka nisur në lidhje me mospërmbushjen prej tij të detyrimeve sipas ligjit të dekriminalizimit, për sa i përket mosdeklarimit të të dhënave, masa disiplinore është marrë në bazë të informacionit se ai figuron i regjistruar si person me precedent kriminal, me dosje të arkivuar nga strukturat e hetimit të krimit në DVP-në, Tiranë, mbështetur në ligjin dhe rregulloren e Policisë së Shtetit. Gjykata e Lartë, në përmbushje të funksionit të saj si gjykatë e ligjit nuk u ka dhënë përgjigje disa aspekteve të rëndësishme për çështjen, duke lënë jashtë analizës juridike jo vetëm çështjet e ngritura në rekurs dhe në kundërrekurs, por edhe ato çështje të lidhura me interpretimin e ligjit, të cilat do të shërbenin për të sqaruar çdo paqartësi në të kuptuarin e normës dhe për të cilat palët duhet të merrnin përgjigje të arsyetuar.

Efektiviteti i mjeteve juridike për konstatimin e cenimit të kohëzgjatjes së paarsyeshme (vendim nr. 44, datë 26.09.2023 - kërkuese Dashmira Zaro)

Shqyrtimi në gjykatën e apelit të mjetit kompensues, që ka për qëllim të riparojë pasojat e tejzgjatjes së procedurave, nuk mund të tejkalojë një afat të arsyeshëm, pasi kjo do e zhvishte atë nga çdo efekt praktik. Interpretimi i ngushtë që gjykata e apelit i bën përmbajtjes së nenit 399/7 të Kodit të Procedurës Civile cenon vetë thelbin e së drejtës kushtetuese së një individi për të pasur një gjykim të drejtë, brenda një afati të arsyeshëm.

Kërkuesja është shpronësuar për interes publik, me vendim të Këshillit të Ministrave. Për shkak se mbi bazën e kësaj VKM-je, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ka kufizuar pronën e kërkueses, ajo ka paraqitur padi në gjykatë, e cila është pranuar pjesërisht. Mbi ankimin e kërkueses çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit. Në pritje të shqyrtimit të ankimit kërkuësja ka paraqitur kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, që është rrëzuar nga Gjykata e Lartë. Kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues, për të cilin me vendimin e vitit 2022 është vendosur konstatimi i cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe detyrimi i Gjykatës Administrative të Apelit të gjykojë çështjen brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit. Në vijim, me vendim të gjykatës së shkallës së parë kërkuësja është shpërblyer në masën 200,000 (dyqind mijë) lekë për dëmin jopasuror për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes. Ky vendim është ankimuar në gjykatën e apelit nga palët e paditura dhe në pritje të gjykimit kërkuësja ka paraqitur kërkesë për përshpejtimin e tij dhe më pas kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit. Duke qenë se as ankimi dhe as kërkesa për përshpejtim nuk u shqyrtuan brenda afateve ligjore, kërkuësja ka paraqitur ankim kushtetues individual për konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit të çështjes së themelit, si dhe konstatimin e mungesës së një mjeti ligjor efektiv për përshpejtimin e gjykimit.

Gjykata vuri në diskutim interesin e kërkueses në këtë çështje, duke vlerësuar se ajo mund të pretendojë ende statusin e viktimës, pasi edhe pse i është njohur shpërblimi i dëmit moral, ky vendim nuk ka marrë ende formë të prerë dhe nuk është ekzekutuar. Në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve juridike Gjykata vlerësoi se edhe pse kërkuësja, formalisht, ka paraqitur kërkesë për konstatimin e vonës në shqyrtimin e çështjes së saj civile, një rrethanë e tillë nuk është e rëndësishme në drejtim të legjitimitetit, pasi ky lloj gjykimi nuk kërkon shterimin e mjeteve juridike.

Në lidhje me efektivitetin e mjetit kompensues, Gjykata vlerësoi në rastin e një mjeti kompensues që ka për qëllim të riparojë pasojat e tejzgjatjes së procedurave, periudha kohore e shqyrtimit të tij nuk mund të tejkalojë një afat të arsyeshëm, pasi kjo do e zhvishte atë nga çdo efekt praktik. Edhe pse neni 399/7 i Kodit të Procedurës Civile, që parashikon një afat 3-mujor, i parë së bashku me nenin 399/6, pika 3, të tij, nuk i referohet shqyrtimit të ankimit, qasja e ofruar nga vetë gjykata e apelit për mënyrën e zbatimit të saj nuk përputhet me përmbajtjen dhe qëllimin e dispozitave që kanë rregulluar mjetet mbrojtëse korrigjuese/kompensuese. Interpretimi i ngushtë që gjykata e apelit i bën përmbajtjes së nenit 399/7 cenon vetë thelbin e së drejtës kushtetuese së një individi për të pasur një gjykim të drejtë, brenda një afati të arsyeshëm.



Kërkesat ligjore për nënshkrimin e rekursit nga mbrojtësi dhe për dhënien e ndihmës juridike falas nuk mund të kthehen në pengesë në drejtim të aksesit (vendim nr. 45, datë 03.10.2023 - kërkuar Ilir Muzhaqi)

Detyrimi ligjor për nënshkrimin e rekursit nga mbrojtësi përbën një garanci të shtuar në drejtim të aksesit të individit në Gjykatën e Lartë, si gjykatë e ligjit, dhe nuk mund të interpretohet dhe zbatohet në mënyrë të atillë sa të çojë në kufizimin e kësaj të drejte. Mosgarantimi i mbrojtësit kryesisht nga Gjykata e Lartë, arsyetimi i pasaktë i saj se kërkuar nuk kishte paraqitur kërkesë për ndihmë juridike dytësore falas dhe mangësitë në bashkëpunimin ndërinstitucional, kanë cenuar thelbin e së drejtës së aksesit.

Kërkuar është deklaruar fajtor për veprat penale "Kallëzimi i rremë" dhe "Mashtrimi" dhe në bashkim të dënimeve është dënuar me 3 vjet burgim. Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit dhe në vijim është ushtruar ankim kundër vendimit penal të dënimit të kërkuar. Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur mospranimin e ankimit me arsyetimin se është paraqitur jashtë afatit ligjor 10-ditor. Rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë është kthyer pa veprim për shkak të mosnënshkrimit nga avokati, sipas nenit 435, pika 2, të Kodit të Procedurës Penale. Në funksion të plotësimit të kësaj të mete, kërkuar ka depozituar një akt me shkrim, ku ka parashtruar se mbrojtjen e ka realizuar vetë dhe rekursin e ka paraqitur të nënshkruar, ndërkohë që Gjykata e Lartë, në bazë të nenit 435, pika 2, të Kodit të Procedurës Penale kishte detyrimin të caktonte një mbrojtës kryesisht. Ai i është drejtuar edhe Ministrisë së Drejtësisë me kërkesë për sigurimin e një mbrojtësi për nënshkrimin e rekursit. Kërkesa i është përcjellë Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike, i cili ka vendosur dhënien e ndihmës juridike në formën e përfaqësimit, duke i caktuar avokat. Në vijim, Kolegji Penal ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se nuk është nënshkruar nga mbrojtësi dhe se kërkuar nuk është në kushtet e mbrojtjes së detyrueshme dhe as nuk rezultojnë të ketë paraqitur kërkesë për ndihmë juridike dytësore falas, sipas ligjit. Kërkuar ka paraqitur ankim kushtetues individual.

Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar se si mund të plotësohet kërkesa e ligjit procedural penal për paraqitjen e rekursit kundrejt nënshkrimit nga mbrojtësi në rastin e një të pandehuri që nuk ka një të tillë dhe, në këtë kuptim, se si i garantohet këtij të pandehuri e drejta e aksesit në këtë gjykatë. Nga materialet e çështjes rezultojnë se kërkuar i është drejtuar Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike me kërkesë dhe i është caktuar avokat për ofrimin e ndihmës juridike në formën e përfaqësimit në çështjen penale me objekt "Rekurs penal ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë." Ky informacion, në kuadër të bashkëpunimit institucional, nuk i është përcjellë Gjykatës së Lartë me qëllim garantimin e së drejtës së aksesit të kërkuar. Edhe vetë Gjykata e Lartë, pavarësisht kërkesës së kërkuar, nuk i ka siguruar atij mbrojtës për t'i mundësuar ushtrimin efektiv të së drejtës së rekursit, në kushtet kur ai nuk ka pasur një të tillë gjatë procesit, ndërkohë që ligji kërkon nënshkrimin e rekursit nga një mbrojtës. Për më tepër, ajo ka vendosur mospranimin e rekursit, ndonëse kërkuar ankohej pikërisht për cenimin e së drejtës së aksesit nga Gjykata e Apelit Tiranë, si rrjedhojë e llogaritjes së gabuar nga kjo e fundit të afatit të paraqitjes së ankimit, konkretisht llogaritjes si datë fillimi të kohës së shpalljes së vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, ndonëse ky vendim ishte shpallur në mungesë të tij.

Kriteret e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm (vendim nr. 46, datë 03.10.2023 – kërkuar Gëzim Boçari)

Kompleksiteti i çështjes nuk mbartet në të njëjtën mënyrë në çdo shkallë të gjyqësorit, por varet nga faza në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj dhe shkalla e gjyqësorit në të cilën kërkohet konstatimi i cenimit. Zgjidhja përfundimtare e problemeve që kanë të bëjnë me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave, si çështje jo vetëm me interes publik, por, para së gjithash, me natyrë kushtetuese, përbën prioritet, pasi e drejta e pronës përbën një nga shtyllat kryesore ku mbështetet sistemi ekonomik dhe zhvillimi i vendit. Kohëzgjatja e procesit gjyqësor në rastin konkret ka bërë të pazbatueshëm, pjesërisht, edhe vendimin e GJEDNJ-së.

Kërkuar dhe trashëgimtarët e tjerë të ish-pronarëve kanë kundërshtuar në gjykatë disa vendime të organeve administrative që janë shprehur për të drejtën e pronës së tyre dhe që kanë disponuar në favor të disa personave të tjerë (pala e paditur në procesin gjyqësor) për disa pasuri që ata pretendojnë se mbivendosen me pasuritë e tyre. Gjykata e shkallës së parë ka pranuar pjesërisht padinë kurse gjykata e apelit ka vendosur rrëzimin e saj. Mbi rekursin e kërkuar çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë dhe në pritje të gjyqësorit kërkuar i është drejtuar po asaj gjykate me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjyqësorit. Kolegji Penal ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se vonesa është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret dhe se ajo gjykatë është në pamundësi objektive të urdhërojë marrjen e masave për përshpejtimin e çështjes. Për rrjedhojë kërkuar ka paraqitur ankim kushtetues për shfuqizimin e këtij vendimi dhe përshpejtimin e procedurave.

Duke analizuar kriteret e kohëzgjatjes së arsyeshme, Gjykata theksoi se gjyqësori në gjykatën e ligjit nuk paraqet të njëjtat elemente kompleksiteti si në shkallët e tjera të gjyqësorit. Edhe pse një çështje, referuar objektit, palëve ndërgjyqëse dhe volumit të akteve shkresore e dokumenteve të administruara mund të mbartet kompleksiteti në gjykatat e faktit, kjo mund të mos jetë e tillë në Gjykatën e Lartë, për shkak të natyrës së atij gjyqësori dhe procedurës së gjyqësorit në dhomën e këshillimit, si dhe funksionit të saj si gjykatë e ligjit. Kurse në lidhje me kriterin e rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuar, Gjykata konstatoi se kërkuar ka qenë palë në disa procese gjyqësore që lidhen me këto pasuri të paluajtshme dhe se vendimi i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave i vitit 1997 ka qenë objekt edhe i një procesi tjetër gjyqësor, që më tej është kundërshtuar në GJEDNJ. Në lidhje me atë proces gjyqësor GJEDNJ-ja ka arritur në përfundimin se kohëzgjatja e tij nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 6 të Konventës. Megjithatë ende nuk ka një vendim përfundimtar të gjykatës në lidhje me të drejtën e pronës së pretenduar të cenuar ndaj vonesat në gjyqësor kanë bërë të pazbatueshëm, pjesërisht, edhe vendimin e GJEDNJ-së. Duke pasur parasysh këtë dhe rëndësinë që ka e drejta kushtetuese e pronës private, nga e cila rrjedh edhe e drejta për ta gëzuar e disponuar atë, si dhe e drejta e kompensimit sipas kuadrit ligjor në fuqi, kohëzgjatja e procedurave gjyqësore në rastin konkret ka rëndësi në drejtim të asaj që rrezikojnë paditësit si palë në procesin gjyqësor.



**Cenimi i parimit të sigurisë juridike
për shkak të pranimit të rekursit të
paraqitur jashtë afatit ligjor (vendimi
nr. 59, datë 14.11.2023 - kërkuës
Kujtim Hoxha)**

Pranimi i rekursit të paraqitur jashtë afatit ligjor, pa arritur të provojë rekursuesi se ka qenë në pamundësi efektive për t'u njohur me vendimin e gjykatës së apelit ose momentin se kur është njohur efektivisht me arsyetimin e tij cenon parimin e sigurisë juridike. Interpretimi dhe qëndrimi i Gjykatës së Lartë ka sjellë faktikisht zgjatjen e afatit kohor për përdorimin e një mjeti të zakonshëm ankimi, ndërkohë që legjislacioni në fuqi ka parashikuar mjete juridike në dispozicion të palëve që kanë humbur ose tejkaluar afatet procedurale.

Në favor të kërkuësit organi administrativ ka vendosur të njohë të drejtën e pronësisë dhe kthimin e sipërfaqeve tokë bujqësore, sipas kufijve përkatës. Këto vendime janë shfuqizuar me vendimet e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, bazuar në ligjin e kohës. Mbi padinë e kërkuësit gjykata e shkallës së parë ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve, vendim që është lënë në fuqi nga gjykata e apelit. Kundër vendimit ka ushtruar rekurs Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka prishur vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, duke e dërguar çështjen për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, si gjykata kompetente. Kërkuësi ka paraqitur ankim kushtetues individual.

Gjykata vlerësoi fillimisht, në drejtim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, se ajo e shqyrton çështjen në mënyrë përjashtimore, pasi shkelja dhe pasojat e saj janë të tilla që nuk mund të riparohen më gjatë rigjyimit të çështjes, për rrjedhojë kërkuësi nuk ka mjete të tjera për mbrojtjen e të drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar.

Në drejtim të parimit të sigurisë juridike, Gjykata konstatoi se vendimi i gjykatës së apelit i është njoftuar palës së paditur (Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave) në datën 22.09.2014, që rezulton jo vetëm nga vula e vendosur në dëftesën e komunikimit, por edhe nga regjistri i dokumenteve të hyra në institucion, i plotësuar nga personi i ngarkuar me pranimin e akteve. Ky fakt është pranuar edhe gjatë gjyqimit në Gjykatën e Lartë nga Avokatura e Shtetit, si përfaqësuese e palës së paditur. Këto fakte janë të mjaftueshme për të provuar se ajo datë është ajo nga e cila ka filluar të ecë afati 30-ditor për paraqitjen e rekursit. Me përfundimin e këtij afati vendimi i gjykatës së apelit ka marrë formë të prerë dhe përbën gjë të gjykuar. Gjykata e Lartë jo vetëm që i ka anashkaluar këto fakte, por edhe pse ka pranuar se rekursi është paraqitur me vonesë, nuk ka administruar asnjë provë dhe nuk ka argumentuar, për rrjedhojë, një moment të ndryshëm nga i cili ka nisur ky afat. Mënyra e arsyetimit të Gjykatës së Lartë dhe argumentet e saj e çojnë këtë arsyetim në kufijtë e arbitraritetit, duke e bërë gjykimin të padrejtë.

Të drejta substanciale

Masa e arrestit nuk shuhet nëse vendimi i pafajësisë nuk ka marrë formë të prerë (vendim nr. 19, datë 04.04.2023 - kërkues Agron Laçaj)

Kufizimi me vendim gjyqësor dhe sipas procedurave të parashikuara nga ligji i lirisë personale, bazuar në dyshime të arsyeshme për kryerjen e veprave penale, nuk cenon lirinë personale. Në rastet kur vendoset prishja e vendimit të gjykatës së apelit, që ka deklaruar kërkuesin fajtor, dhe çështja kthehet për rigjykim në shkallë të dytë për vlerësimin e vendimit të pafajësisë të gjykatës së shkallës së parë, për sa kohë vendimi nuk ka marrë formë të prerë, kërkuesi ruan të njëjtin status procedural.

Në vitin 2000 kërkuesi është dënuar nga gjykata e shkallës së parë me 25 vjet burgim për kryerjen e veprave penale "Vrasja me dashje" dhe "Mbajtja pa leje e armëve luftarake". Vendimi është prishur nga gjykata e apelit dhe në rigjykim gjykata e shkallës së parë ka vendosur deklarin e pafajshëm të kërkuesit. Vendimi i pafajësisë është prishur sërish nga gjykata e apelit, e cila e ka deklaruar kërkuesin fajtor për këto vepra penale, duke e dënuar me 25 vjet burgim. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Kërkuesi ka paraqitur kërkesë për konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit personal "Arresti në burg" në fuqi ndaj tij, duke pretenduar se në kushtet kur vendimi i fajësisë i Gjykatës së Apelit Shkodër është shfuqizuar, prodhon efekte vendimi i pafajësisë që ka shuar edhe masën e sigurimit personal ndaj tij. Gjykata e apelit ka konstatuar faktin se masa e sigurimit "Arrest në burg" e dhënë me vendimin e fajësisë është shuar dhe ka pranuar kërkesën e prokurorit, duke i caktuar po këtë masë sigurimi. Kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, për të cilin është vendosur mospranimi, dhe më pas ka paraqitur ankim kushtetues.

Në drejtim të lirisë personale Gjykata vlerësoi se ndonëse vendimi i fajësisë është prishur dhe çështja është kthyer për rigjykim në shkallën e dytë për të vlerësuar bazueshmërinë e vendimit të pafajësisë, për sa kohë vendimi i shkallës së parë nuk ka marrë formë të prerë, kërkuesi ruan të njëjtin status procedural. Gjykata e apelit ka analizuar faktet dhe provat në raport me kushtet dhe kriteret për kufizimin e lirisë personale, duke arsyetuar vendimin e saj si për sa u takon pretendimeve të tij për cenimin e lirisë personale, ashtu edhe për sa u përket konkluzioneve të arritura prej saj për ekzistencën e "dyshimeve të arsyeshme" për kufizimin e kësaj të drejte. Pretendimet e ngritura në rekurs janë analizuar dhe vlerësuar nga Gjykata e Lartë, e cila ka arsyetuar gjetjet e saj në drejtim të të drejtave procedurale dhe kushtetuese të tij. Interpretimi dhe zbatimi i ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm janë bërë duke marrë parasysh garancitë që ofron parimi i procesit të rregullt ligjor dhe se në rastin konkret nuk shfaqen probleme në aspektin kushtetues, të tilla që do të kërkonin ndërhyrjen e Gjykatës.

Në drejtim të pretendimit për cenimin e parimit të gjykitimit nga një gjykatë e paanshme, pasi kërkesa për konstatimin e humbjes së fuqisë së masës dhe ajo për shuarjen e saj janë shqyrtuar nga i njëjti trup gjykues i gjykatës së apelit, Gjykata vlerësoi, në përputhje me parashikimet procedurale dhe praktikën e Gjykatës së Lartë, se kur kërkesa është paraqitur për gjykim kompetenca për të vendosur caktimin, zëvendësimin a revokimin e masave të sigurimit i përket vetëm gjykatës së caktuar për shqyrtimin e çështjes. Shqyrtimi nga i njëjti trup gjykues i këtyre kërkesave nuk cenon parimin e paanshmërisë në aspektin objektiv.



Alternativa e dënimit me burgim nuk është një dënim i ri, por ai përjashton ekzekutimin e menjëhershëm të tij duke u zëvendësuar me vënien në provë (vendimi nr. 24, datë 27.04.2023 – kërkues Klaudio Burimi)

Sanksioni penal i cilësdo natyre duhet të synojë vetëm riedukimin dhe më pas integrimin e të dënuarit në jetën shoqërore. Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar situatën konkrete të kërkuesit në drejtim të zbatimit të vendimit dhe urdhërimeve të gjykatës së apelit ose fazën e ekzekutimit nga ai të dënimit alternativ. As fakti i vuajtjes së dënimit alternativ nga kërkuesi nuk gjen pasqyrim në përmbajtjen e vendimit. Kërkuesi është ngarkuar të vuajë sërish një pjesë të dënimit me burgim të vuajtur më parë prej tij në një prej mënyrave alternative të këtij dënimi.

Përmes rritit të gjykimit të shkurtuar, kërkuesi është dënuar me 4 vjet e 8 muaj burgim nga gjykata e rrethit për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”. Gjykata e apelit ka ndryshuar pjesërisht vendimin, duke e dënuar kërkuesin me të njëjtën masë dënimi, por për pjesën e pavuajtur të tij, në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, ka urdhëruar që ai të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit me kusht që gjatë kohës së provës prej 3 vjetësh të mos kryejë vepër tjetër penale. Masa e sigurimit “Arresti në burg” është shuar dhe kërkuesi është liruar menjëherë nga paraburgimi. Gjatë kohës që rekursi i ushtruar nga prokuroria pritej të shqyrtohej në Gjykatën e Lartë, me vendim të prokurorisë është konstatuar kryerja nga kërkuesi e dënimit alternativ dhe pushimi i ekzekutimit të urdhrit për ekzekutimin e vendimeve penale. Në vijim, Kolegji Penal ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të gjykatës së rrethit, si dhe njoftimin e Prokurorisë së Përgjithshme për vënien në ekzekutim të këtij vendimi. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues individual.

Gjykata, në lidhje me pretendimin e cenimit të lirisë personale të lidhur me arsyetimin e vendimit, ka vlerësuar se me përmbushjen e detyrimeve të caktuara gjatë kohës së provës, vendimi i dënimit alternativ është ekzekutuar sipas ligjit dhe prokurori ka nxjerrë vendim të veçantë për kryerjen e tij. Në këtë mënyrë, kërkuesi ka vuajtur tërësisht dënimin e caktuar. Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar situatën konkrete të kërkuesit në drejtim të zbatimit prej tij të vendimit dhe urdhërimeve të gjykatës së apelit ose fazën e ekzekutimit nga ai të dënimit alternativ. Fakti i vuajtjes së dënimit alternativ nga kërkuesi nuk gjen pasqyrim në përmbajtjen e arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë. Ndërsa ekzekutimi i dënimit për shkak të kohës së kaluar potencialisht duhet të kishte përfunduar, çka passillte implikime për vendimin që asaj i është kërkuar të jepte, Gjykata e Lartë ka pasur detyrimin për marrjen e informacionit në këtë drejtim, për të shmangur në këtë mënyrë rindëshkimin e kërkuesit pas shlyerjes më parë të dënimit.

Zbatimi i parimit ne bis in idem në rastet e dënimeve alternative (vendimi nr. 47, datë 05.10.2023 – kërkues Klaudio Perçuke, Kejvin Zogo)

Ideja e parimit të mosgjyqimit dy herë për të njëjtën vepër penale (ne bis in idem) nuk qëndron te zbatimi dy a më shumë herë i së njëjtës normë penale, por te mosgjykimi e mosdënimi përsëri i subjektit për të njëjtin fakt që përbën vepër penale, për të cilën ai është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e caktuar me ligj. Për kërkuesin, për të njëjtën sjellje dhe veprim, nuk është zhvilluar ndonjë proces tjetër dhe as nuk është gjykuar dhe dënuar më shumë se një herë për të njëjtin fakt penal.

Kërkuesit janë deklaruar fajtorë nga gjykata e shkallë së parë për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe janë dënuar me 7 vjet burgim dhe duke qenë se janë gjykuar sipas rritit të gjyqimit të shkurtuar, u është zbritur një e treta e dënimit. Gjykata e Apelit Vlorë ka ndryshuar vendimin në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale dhe dënimin, duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm të kërkuesve, në rrethanat kur për njërin ka pezulluar ekzekutimin e dënimit me burgim, ndërsa për tjetrin konstatoi vuajtjen tërësisht të dënimit. Mbi rekursin e prokurorisë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kërkuesit kanë paraqitur ankim kushtetues individual.

Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për t`u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, Gjykata vlerësoi se Gjykata e Lartë nuk ka shqyrtuar asnjë provë të re dhe nuk u ka dhënë vlerë të ndryshme provave të administruara nga gjykatat më të ulëta, si dhe nuk ka përcaktuar fakte të ndryshme nga ato që kanë përcaktuar këto të fundit.

Kërkuesi Klaudio Perçuke ka pretenduar edhe cenimin e parimit të mosdënimit dy herë për të njëjtën vepër penale, pasi referuar vendimit të gjykatës së apelit ai e ka shlyer dënimin me shërbim prove. Duke u prishur ai vendim nga Gjykata e Lartë do të kryejë dënimin dy herë për të njëjtin fakt penal. Në kuptim të parimit ne bis in idem, Gjykata evidentoi se ndaj kërkuesit është zhvilluar vetëm një proces penal për akuzën e ngritur nga prokuroria dhe nuk rezulton që për të njëjtën sjellje dhe veprim të jetë zhvilluar ndaj tij një proces i dytë gjyqësor ose që të jetë gjykuar dhe dënuar më shumë se një herë për të njëjtin fakt penal. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është vënë në lëvizje rregullisht me rekurs brenda të njëjtit procedim penal dhe në përfundim të shqyrtimit të rekursit, ai ka disponuar për cilësimin juridik të veprës penale të kryer dhe alternativën e dënimit me burgim.



E drejta e pronës private mund të kufizohet për interes publik nëse ai është aktual dhe jo potencial (vendimi nr. 50, datë 18.10.2023 - kërkuar Muhamet Trepçi)

Koncepti kushtetues i interesit publik vlerësohet nga Gjykata në këndvështrim të aktit konkret që paraqitet për kontroll përpara saj. Shteti nuk mund të justifikojë kufizimin e së drejtës së pronës me pretendimin e realizimit të planeve rregulluese në të ardhmen. Gjykata e Lartë nuk ka argumentuar për pretendimin thelbësor që ka të bëjë me interpretimin e ligjit të zbatueshëm në raport me interesin publik që mbart prona e kërkuar dhe as për cenimin e parimit të proporcionalitetit në ndërhyrjen në këtë drejtë.

Kërkuar dhe trashëgimtarëve të tjerë të subjektit të shpronësuar u është njohur e drejta e pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme truall dhe e drejta për t'u kompensuar, pasi, sipas organit administrativ, ajo ishte regjistruar në inventarin e pasurive të bashkisë së qytetit dhe i shërbente interesit publik duke u kthyer në hapësirë publike (lulishte). Këta shtetas i janë drejtuar gjykatës me padi për anulimin pjesërisht të këtij vendimi. Me vendim të gjykatës së shkallës së parë është pranuar padia dhe kjo sipërfaqe i është kthyer paditësve. Gjykata e apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë, kurse Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit. Kërkuar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar cenimin e së drejtës së pronës private dhe asaj për proces të rregullt.

Gjykata e vlerësoi çështjen në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në lidhje me të drejtën e pronës. Në kohën e gjykimit të çështjes së kërkuar, sipas legjislacionit në fuqi nuk ktheheshin pronat e paluajtshme që i shërbenin një interesi publik, çka është përcaktuar drejt nga gjykatat e zakonshme gjatë vlerësimit të kriterit të ndërhyrjes me ligj në të drejtën e pronës. Po kështu ka rezultuar se me VKM parcela "lulishte-pazar" është përfshirë në listën paraprake të pronave të paluajtshme, publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë së qytetit, ndërkohë që lista përfundimtare e pronave kaluar kësaj bashkie është miratuar me VKM në vitin 2010. Gjykata e apelit e ka mbështetur kufizimin e të drejtës së pronës së kërkuar me interesin potencial në të ardhmen, ndërsa Gjykata e Lartë nuk ka analizuar ose vlerësuar pretendimet për cenimin e parimit të proporcionalitetit në ndërhyrjen në të drejtën e pronës, pavarësisht se janë ngritur gjatë procesit gjyqësor ose të ketë arsyetuar për balancën që duhet të ekzistojë mes interesit publik dhe ndërhyrjes në këtë të drejtë kushtetuese. Ajo nuk ka argumentuar për pretendimin thelbësor të kërkuar që lidhet drejtpërsëdrejti me funksionin kushtetues të saj për interpretimin e ligjit në raport me interesin publik që mbart prona e tij, për të cilën pretendohet kthimi fizik dhe jo kompensimi, si dhe të akteve nënligjore që e kanë përcaktuar si pronë për interes publik. Vendimi i Gjykatës së Lartë është i pamjaftueshëm dhe nuk përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në lidhje me të drejtën e pronës.

Cenimi i së drejtës substanciale të pronës private jashtë së drejtës për proces të rregullt (vendimi nr. 53, datë 31.10.2023 - kërkues Terenzio D`Alena)

Cenimi qoftë edhe i pjesshëm i njërit prej tagrave të pronarit ose i njërit prej elementeve përbërëse të çdo tagri të pronësisë përbën në vetvete cenimin e së drejtës të pronës në tërësinë e saj. Kërkuesi, edhe pse titulli i tij i pronësisë nuk është vënë në diskutim, nuk ushtron asnjë prej tre tagrave të pronësisë. Interpretimi që gjykatat i kanë bërë kontratës dhe të drejtave të palëve, e kanë kufizuar aftësinë e kërkuesit për të ushtruar të drejtën në atë masë sa që e kanë privuar prej saj.

Trashëgimtarit të kërkuesit i është konfiskuar në vitin 1946 nga shteti një shtëpi dhe një truall. Pas hyrjes në fuqi të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave, kërkuesi i është drejtuar organit administrativ për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin e pronës. Në vitin 1992, Bashkia Tiranë dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve i kanë dhënë me qira një shoqërie private një truall, në një pjesë të të cilit do të ndërtohej një hotel, kurse pjesa tjetër do të ishte sipërfaqe funksionale. Në vitin 1993 është miratuar leja për ndërtimin e hotelit (faza e parë). Në vitin 1993, trashëgimtarëve të ish-pronarit u është kthyer shtëpia e konfiskuar dhe në vitin 1994 u është njohur e drejta e pronësisë mbi truallin ku ndodhej shtëpia. Në vitin 1996 u është njohur e drejta e pronësisë edhe mbi një sipërfaqe tjetër trualli, ku për pjesën e zënë nga hoteli janë kompensuar sipas ligjit, ndërkohë që një pjesë u është kthyer si truall i lirë dhe ai është regjistruar rregullisht në regjistrat publikë të kohës. Për këtë pasuri, e gjendur brenda sipërfaqes funksionale të hotelit, kërkuesi ka ngritur padi lirim dhe dorëzimin e saj. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e padisë, që është lënë në fuqi nga gjykata e apelit. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, i cili i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për cenimin e së drejtës së pronës private.

Gjykata vlerësoi se kërkuesi është titullar i pakontestuar i së drejtës së pronës mbi truallin objekt i mosmarrëveshjes në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe se mbi të drejtën e tij për gëzimin e pronës private është zbatuar një kufizim, në formën e detyrimit për të respektuar afatin e një kontrate qiraje të lidhur midis shtetit dhe një subjekti privat. Edhe pse titulli i pronësisë mbi truallin nuk është vënë në diskutim, kërkuesi nuk është në gjendje të ushtrojë asnjë prej tagrave të pronësisë. Në kushtet kur kërkuesi nuk e gëzon pronën, pasi edhe pse ka një titull pronësie të regjistruar në regjistrat përkatës publikë nuk e posedon faktikisht atë, ka cenim në këtë të drejtë. Edhe pse kontrata e qirasë nuk përbën shpronësim de jure, dhënia e pasurisë me qira për një afat 99-vjeçar, si dhe interpretimi që gjykatat i kanë bërë kësaj kontrate dhe të drejtave të palëve të saj, e kufizojnë aftësinë e kërkuesit për të ushtruar të drejtën e pronës në atë shkallë sa ngjason me një shpronësim de facto pa shpërblim në kuptim të nenit 41 të Kushtetutës. Ky kufizim është në atë masë sa që në fakt ka cenuar thelbin e së drejtës së pronës, duke e bërë iluzive atë. Kufizimi nuk plotëson as kriterin e proporcionalitetit, për sa kohë që mes interesave që vihen në diskutim, atij të qiramarrësit dhe interesit të kërkuesit, barra dukshëm anon nga interesi kushtetues i kërkuesit, duke mos u gjetur kështu ekuilibri i duhur mes qëllimit që është synuar të arrihet përmes dhënies me qira të truallit dhe mbrojtjes së të drejtës së pronës private. Gjykata e Lartë duhej t`u jepte përgjigje pretendimeve të kërkuesit gjatë procesit gjyqësor për ndërhyrjen në të drejtën kushtetuese të pronës, të cilat nuk mund të vlerësoheshin në dhomën e këshillimit, por kërkonin trajtim në themel në seancë gjyqësore.



**Kufizimi i lirisë për shkak të ekstradimit
(vendimi nr. 51, datë 18.10.2023 -
kërkues Ermal Gjokja)**

Procedura e caktimit të masave shtrënguese në rastin e kërkesës për ekstradim ka natyrë të veçantë përkundrejt procedimit tipik penal. Kushtëzimi i caktimit të masës lidhet me ecurinë e procedurës dhe zbatohet deri në marrjen formë të prerë të vendimit për shqyrtimin e kërkesës për ekstradim. Në këto raste konsiderohet “gjë e gjykuar” vendimarrja e Gjykatës së Lartë.

Ndaj kërkuesit është caktuar masa shtrënguese e lirisë personale “Arresti në burg”, për qëllime ekstradimi drejt shtetit italian ku ai ishte dënuar për kryerjen e disa veprave penale. Në lidhje me kërkesën për ekstradim, gjykata e shkallës së parë ka vendosur mospranimin e saj. Gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit. Mbi rekursin e prokurorit Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim. Në kushtet kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur moslejimin e ekstradimit, kërkuesi ka kërkuar revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit personal dhe konstatimin e shuarjes së saj, për të cilën është vendosur rrëzimi, vendim që është lënë në fuqi nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka kundërshtuar cenimin e lirisë personale, për shkak të vijimit të zbatimit të masës së sigurimit, pavarësisht ekzistencës së vendimeve gjyqësore që nuk lejonin ekstradimin e tij.

Gjykata ka mbajtur qëndrimin se Gjykata e Lartë ka vlerësuar interpretimin që gjykatat më të ulëta u kanë bërë dispozitave procedurale penale që rregullojnë caktimin e masave shtrënguese për qëllime të ekstradimit, për aq sa ato mund të zbatohen, duke pasur parasysh kërkesat për të garantuar që personi për të cilin është kërkuar ekstradimi të mos i shmanget dorëzimit. Gjykata e Lartë ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e gjykatës së apelit në lidhje me vendimarrjen jopërfundimtare të gjykatës së shkallës së parë për çështjen e ekstradimit, duke vlerësuar se kjo vendimarrje nuk sjell efekt, pasi ligjvënësi i ka shtrirë efektet e procedurës në të tria shkallët e gjykimit, duke konsideruar “gjë të gjykuar” vendimarrjen e Gjykatës së Lartë. Pretendimet e ngritura gjatë procesit gjyqësor janë vlerësuar përkundjet fakteve dhe provave të marra gjatë gjykimit nga gjykatat më të ulëta në raport me rregullimet ligjore që përcaktojnë caktimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg” në rastin e tij.

Parimi i prezumimit të pafajësisë në rastin e provave të mbledhura në kushtet e dhunës (vendimi nr. 63, datë 20.11.2023 - kërkues Mariglen Gjura)

Konventa nuk i ndalon prezumimet ligjore ose të faktit në çështjet penale, por ato duhet të jenë brenda kufijve të arsyeshëm, duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e interesit që rrezikohet dhe të sigurojnë të drejtat e mbrojtjes. Gjykatat i kanë kaluar kërkuesit barrën e provës, duke i vendosur detyrimin për të provuar se armët e sekuestruara nuk i përkisnin atij, duke përcaktuar kështu fajësinë me anë të prezumimeve të faktit.

Gjatë një operacioni të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe forcave speciale për arrestimin e një të dyshuari është hyrë me forcë në banesën e kërkuesit dhe është ushtruar dhunë për neutralizimin e tij. Edhe pse personi i kërkuar nuk është gjetur, gjatë kontrollit në banesë janë gjetur disa armë të ftohta dhe zjarri. Kërkuesi është arrestuar në flagrancë dhe ndaj tij ka nisur procedimi penal dhe ai është dërguar në gjyq për kryerjen e veprave penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit", "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive". Disa ditë pas arrestimit, prindërit e kërkuesit janë ankuar për dhunën e ushtruar nga punonjësit e Policisë së Shtetit tek Avokati i Popullit, i cili ka konkluduar se pretendimet për keqtrajtim fizik ishin të drejta dhe i ka rekomanduar drejtuesit të Prokurorisë fillimin e hetimeve në ngarkim të punonjësve të policisë së shtetit. Në vijim është regjistruar procedimi penal për veprën penale "Tortura në bashkëpunim" dhe për njërin prej oficerëve të policisë është vendosur deklarimi fajtor dhe është dënua për veprën penale "Kryerja e veprimeve arbitrare", çështje që pritet të shqyrtohet në apel. Kurse për sa i takon procedimit penal të kërkuesit, gjykata e shkallës së parë ka vendosur deklarimin fajtor dhe dënimin e tij për veprat penale për të cilat është akuzuar, vendim që është lënë pjesërisht në fuqi, duke rritur masën e dënimit për njërin nga veprat penale. Për rekursin e kërkuesit Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij. Kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual.

Gjykata e ka shqyrtuar çështjen në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë, për sa kohë është pretenduar se fajësia e kërkuesit nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm dhe se provat e prokurorisë synonin të mbulonin dhunën e ushtruar ndaj tij, pretendime këto që janë ngritur edhe në ankim dhe rekurs. Në analizë të fakteve, Gjykata vërejtë fillimisht se prokuroria, dhe më pas gjykatat e faktit, në deklarimin e fajësisë së kërkuesit janë bazuar në 3 rrethana specifike: (i) prania e kërkuesit gjatë ushtrimit të kontrollit të banesës dhe ambienteve rrethuese të saj; (ii) gjetja dhe sekuestrimi i armëve në ambientet e jashtme të banesës; (iii) gjendja teknike e armëve, sipas akteve të ekspertimit dhe mungesa e lejes për mbajtjen e tyre. Ajo vlerësoi se gjykatat e faktit e kanë çliruar prokurorin nga barra e provës, duke ia kaluar kërkuesit detyrimin për të provuar se armët e sekuestruara nuk i përkisnin atij, me arsyetimin se përgjegjësia penale e veprave penale të mbajtjes së armëve ka natyrë objektive. Ato e kanë përcaktuar fajësinë e kërkuesit me anë të prezumimeve të faktit. Në vlerësimin e Gjykatës, përgjegjësia objektive e kërkuesit për mbajtjen pa leje të armëve është një prezumim fakti i diskutueshëm në kushtet kur armët janë gjetur në një ambient të jashtëm të banesës dhe kur ai nuk jeton vetëm në banesë. Po kështu, prokuroria dhe gjykatat nuk kanë kryer verifikimin e duhur të dhunës së ushtruar ndaj kërkuesit prej punonjësve të policisë gjatë kontrollit të banesës, ndonëse kishin prova dokumentare të vëna në dispozicion nga Avokati i Popullit, por kanë pranuar me fuqi të plotë provues procesverbalin e kontrollit të banesës, të nënshkruar pa vërejtje nga kërkuesi dhe e ëma e tij, pa dhënë asnjë shpjegim edhe pse kjo e fundit ka mohuar faktin që armët i përkasin kërkuesit apo familjarëve të tjerë. Prokuroria nuk ka verifikuar as pretendimet e kërkuesit në fazën e hetimeve paraprake për hetimin e ekzistencës së gjurmëve papilare mbi sendet e sekuestruara dhe eventualisht për t'i krahasuar ato me të kërkuesit. Për rrjedhojë, arsyetimi i vendimeve të gjykatave nuk dëshmon që fajësia e kërkuesit të jetë provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

2023



TË DHËNA STATISTIKORE

Të dhënat statistikore për vitin 2023


Gjatë vitit 2023 Gjykata Kushtetuese ka marrë 452 kërkesa³, nga të cilat 367 kërkesa janë paraqitur dhe regjistruar gjatë vitit 2023, kurse 85 kërkesa janë mbartur nga viti 2022.

KOHËZGJATJA

- Gjykata ka respektuar afatet procedurale të shqyrtimit të kërkesave, në përputhje me parashikimet e ligjit organik dhe Rregullores për Procedurat Gjyqësore.
- Mesatarja e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatë për vendimet përfundimtare është 8 muaj dhe për vendimet e moskalimit është 3 muaj.
- Aktualisht Gjykata Kushtetuese nuk ka në shqyrtim asnjë çështje të prapambetur.
- Asnjë nga kërkesat nuk ka pasur për objekt tejzgjatjen e procesit para Gjykatës Kushtetuese.

■ TË DHËNA MBI KËRKESAT

Kërkesat e grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën




4 kërkesa janë paraqitur nga jo më pak se një e pesta e deputetëve
 6 kërkesa janë paraqitur nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (kontroll incidentale)
 2 kërkesa janë paraqitur nga partitë politike
 12 kërkesa janë paraqitur nga organizatat
 343 kërkesa janë paraqitur nga individët

³ Për shkak se 12 kërkesa janë bashkuar me njëra-tjetrën nuk korrespondon numri i kërkesave me numrin e vendimeve dhe të çështjeve që janë në shqyrtim aktualisht në Gjykatë.

Kërkesa të grupuara sipas objektit:


Objekti:	Nr.
Interpretim i Kushtetutës	1
Papajtueshmëri e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën	2
Shfuqizim i vendimit të Kuvendit të Shqipërisë	1
Papajtueshmëri e ligjeve me Kushtetutën	29
Shfuqizim vendimesh të Këshillit të Ministrave	5
Kundërshtim i akteve të pushtetit publik	4
Kundërshtim i vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm së bashku me papajtueshmërinë e dispozitave ligjore të aplikueshme në atë rast	4
Kundërshtim i vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm	276
Konstatim i cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm	13
Kundërshtim i vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, së bashku me konstatimin e cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm	12
Interpretim/korrigjim/rishikim i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese	20

Kërkesa të grupuara sipas objektit




■ TË DHËNA MBI VENDIMET

Gjykata Kushtetuese gjatë vitit 2023 ka dhënë në total 353 vendime, 70 vendime përfundimtare dhe 283 vendime moskalimi.




Vendimet përfundimtare të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese:



6 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga një grup deputetësh
 2 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (kontroll incidental)
 3 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga organizatat
 59 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga individët


Vendimet përfundimtare të marra gjatë vitit 2023, të grupuara sipas objektit të kërkesës:



2 vendime u përkasin kërkesave me objekt mosmarrëveshje kompetencash dhe vendime të Kuvendit
 6 -me objekt papajtueshmërinë e akteve normative me Kushtetutën
 2 -me objekt shfuqizimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave
 47 -me objekt kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në kuadër të procesit të rregull ligjor
 4 -me objekt shfuqizimin e vendimeve gjyqësore dhe papajtueshmërinë e akteve normative me Kushtetutën
 7 -me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm
 2 -me objekt saktësim/interpretim/rishikim/ të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

Vendimet përfundimtare të marra gjatë 2023 të grupuara sipas dispozitivit të vendimit:

Vendimet përfundimtare sipas dispozitivit




Për 39 vendime Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës/pranimin e pjesshëm
Për 28 vendime Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës
Për 3 vendime Gjykata ka vendosur pushim gjykimi/saktësim vendimi

Vendimet përfundimtare të marra gjatë 2023 të grupuara sipas mënyrës së votimit:

Vendimet përfundimtare sipas mënyrës së votimit

30 vendime janë marrë njëzëri
40 vendime janë marrë me shumicë votash



Gjatë vitit 2023 nga Mbledhja e Gjyqtarëve dhe Kolegjet e Gjykatës Kushtetuese janë dhënë 283 vendime moskalimi.

Vendimet e moskalimit të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese:


Vendime moskalimi sipas subjekteve



2 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga një grup deputetësh
2 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (kontrolli incidental)
2 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga partitë politike
9 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga organizatat
268 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga individët


Vendime moskalimi të grupuara sipas objektit të kërkesës:

Objekti:	Nr.
Interpretim i Kushtetutës	1
Papajtueshmëri e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën	1
Pajtueshmëri të akteve normative me Kushtetutën	17
Shfuqizim vendimi i Këshillit të Ministrave	1
Shfuqizim vendimi të Këshillit të Ministrave së bashku me vendim të gjykatës së juridiksionit të zakonshëm	1
Shfuqizim i vendimeve gjyqësore së bashku me papajtueshmëri të akteve normative me Kushtetutën	2
Kundërshtim të vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në kuadër të procesit të rregull ligjor	216
Konstatim të cenimit të së drejtës për proces të rregullt si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm	23
Saktësim/interpretim/rishikim/kundërshtim vendimi të Gjykatës Kushtetuese	13
Akte të pushtetit publik	8

Vendime moskalimi
sipas objektit

Vendime moskalimi të marra nga Kolegjet dhe Mbledhja e Gjyqtarëve:


Vendime moskalimi nga Kolegjet
dhe Mbledhja e Gjyqtarëve



245 vendime janë marrë nga Kolegjet
38 vendime janë marrë nga Mbledhja e Gjyqtarëve

Tabelë krahasimore 2021-2023, në lidhje me kërkesat e paraqitura dhe vendimarrjet e Gjykatës

Tabelë krahasimore 2021-2023



**Data të rëndësishme për anëtarësimin e Gjykatës Kushtetuese në
organizmat ndërkombëtarë:**

- 2001 -anëtare me të drejta të plota e Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane
- 2002 -anëtare me të drejta të plota e Shoqatës së Gjykatave Kushtetuese Frankofone
- 2011 -anëtare me të drejta të plota e Konferencës Botërore për Drejtësinë Kushtetuese
- 2016 -anëtare e Rrjetit të Gjykatave Supreme Evropiane
- 2023 -anëtare e Forumit të Gjykatave Kushtetuese të Ballkanit

BASHKËPUNIMI DHE PERSPEKTIVA NDËRKOMBËTARE

Aderimi i Gjykatës Kushtetuese në organizma ndërkombëtare

Me synimin për të dhënë kontributin e saj në shërbim të drejtësisë kushtetuese, si një element kyç i shtetit të së drejtës, që prej krijimit të saj në vitin 1992, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka vendosur dhe konsoliduar marrëdhëniet e bashkëpunimit me gjykata kushtetuese të vendeve të tjera, gjykata dhe organizma ndërkombëtarë.

Gjykata ka qenë gjithmonë një anëtare aktive e komunitetit global të gjykatave kushtetuese, me qëllim promovimin e zhvillimit të demokracisë, shtetit të së drejtës, lirive dhe të drejtave themelore të individit. Në këtë kuadër, Gjykata ka aderuar si anëtare më të drejta të plota në një sërë forumesh të rëndësishme rajonale dhe ndërkombëtare. Së fundmi, ajo është bërë anëtare e Forumit të Gjykatave Kushtetuese të Ballkanit, i cili u krijua në nëntor të vitit 2023, me nismën e Gjykatave Kushtetuese të Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut, me qëllim nxitjen dhe promovimin e dialogut gjyqësor mes gjykatave kushtetuese të vendeve të Ballkanit.

Për të zhvilluar dhe konsoliduar më tej marrëdhëniet e bashkëpunimit institucional dhe debatin kushtetues, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të veprimtarisë vendimmarrëse dhe forcimin e kapaciteteve, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ka nënshkruar edhe marrëveshje bashkëpunimi me disa gjykata homologe në Evropë. Këto Memorandume Bashkëpunimi shërbejnë si bazë për shkëmbimin e vazhdueshëm dhe reciprok të përvojave dhe njohurive në fushën e kontrollit kushtetues. Gjithashtu, Gjykata i ka dhënë përparësi thellimit të bashkëpunimit me gjykatat kushtetuese të vendeve fqinje, bashkëpunim i cili është konkretizuar nëpërmjet organizmit të vizitave studimore reciproke, seminareve dhe trajnimeve të ndryshme që kanë pasur në fokus çështjet më aktuale të drejtësisë kushtetuese.

Gjykata gjatë veprimtarisë së saj i kushton një rëndësi të veçantë marrëdhënieve me Këshillin e Evropës, Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Komisionin Evropian për Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias). Vlen të përmendet anëtarësia e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë në Rrjetin e Gjykatave Supreme (SCN), për themelimin e të cilit është nismëtare Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Gjatë vitit 2023 Gjykata ka intensifikuar përpjekjet dhe ka arritur të vendosë marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi edhe me një sërë partnerësh ndërkombëtarë brenda vendit, duke u përfshirë në projekte dhe nisma konkrete që kanë synuar përmirësimin e infrastrukturës, të kapaciteteve njerëzore dhe kuadrit të brendshëm rregullator, në

funksion të rritjes së eficiencës, transparencës dhe aksesit të qytetarëve në drejtësinë kushtetuese.

Përsa më sipër, në funksion ruajtjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese ka vijuar bashkëpunimi i suksesshëm me Prezencën e OSBE-së për disa veprimtari tematike, përfshirë hartimin e udhërrëfyesit të parë të Gjykatës mbi standardet dhe precedentët e Gjykatës ndër vite mbi të drejtën për proces të rregullt ligjor. Në kuadër të të njëjtit bashkëpunim, u realizuan tryeza për standardizimin e akteve të vendimmarrjes, si dhe tryeza me Gjykatën e Lartë në funksion të forcimit të dialogut mes trupave gjyqësore. Gjithashtu, ka vijuar më tej bashkëpunimi i frytshëm i Gjykatës me Prezencën dhe me Fondacionin Konrad Adenauer për planifikimin strategjik institucional për periudhën 2020-2023 dhe 2024-2026.

Duhet thënë se për një shqyrtim cilësor e efikas të çështjeve me qëllim garantimin e një sistemi funksional të drejtësisë kushtetuese, përgjatë vitit 2023, Gjykata bëri përpjekje të vazhdueshme dhe siguroi angazhimin e partnerëve të saj ndërkombëtarë për të mbështetur krijimin e një sistemi tërësisht të ri të administrimit të kërkesave, të bazuar në teknologjinë e informacionit, i cili pritet të materializohet përgjatë periudhës 2024-2025.

Së fundmi, Gjykata Kushtetuese me mbështetjen e Konfederatës Zvicerane nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri ka ndërmarrë Projektin "Rritja e transparencës dhe aksesit në drejtësinë kushtetuese", i cili synon garantimin e të drejtës së informacionit sipas standardeve ndërkombëtare duke forcuar komunikimin me median dhe publikun përmes rikonceptimit të faqes zyrtare të Gjykatës, shpërndarjes së materialeve informuese e sensibilizuese mbi të drejtat dhe liritë kushtetuese. Projekti gjithashtu ka në fokus rritjen e bashkëpunimit me subjektet e gjykimit kushtetues, me institucione që punojnë në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe me gjykatat për të përmirësuar aksesin e individëve në drejtësinë e zakonshme dhe atë kushtetuese.

Gjykata po ashtu, ka realizuar botimin e punimeve të Konferencës Ndërkombëtare të zhvilluar me rastin e 30-vjetorit të themelimit të saj, duke vijuar bashkëpunimin e suksesshëm me Fondacionin Heinz Seidel.



Data të rëndësishme për bashkëpunimin ndërkombëtar:

- 16 korrik 2009 - Marrëveshje për bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjellë në fusha me interes të përbashkët midis Gjykatave Kushtetuese të Shqipërisë dhe të Italisë.
- 18 - 20 prill 2011 - Marrëveshje për bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjellë në fusha me interes të përbashkët midis Gjykatave Kushtetuese të Shqipërisë dhe Kosovës.
- 9 - 12 qershor 2013 - Marrëveshje midis Gjykatave Kushtetuese të Shqipërisë dhe Turqisë.
- 29 shtator 2021 - Nënshkruhet marrëveshja e re me Gjykatën Kushtetuese të Kosovës për bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjellë, ku manifestohet dëshira dhe vullneti për të vazhduar edhe më tej programet e bashkëpunimit, për të forcuar kapacitetet institucionale dhe rritur cilësinë e vendimeve.
- 14 prill 2021 - Memorandum Mirëkuptimi mes Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë dhe Zyrës së Prezencës së OSBE-së në Shqipëri "Për bashkërendimin dhe bashkëpunimin në zbatimin e projekteve dhe veprimtarive që synojnë të mbështesin Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë".
- 27 tetor 2023 - Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Bullgarisë, Këshilli i Shtetit të Republikës së Greqisë, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese e Malit të Zi, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Rumanisë dhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë bien dakord për krijimin e Forumit të Gjykatave Kushtetuese të Ballkanit, si një organ funksional permanent për nxitjen e dialogut gjyqësor.
- 7 dhjetor 2023 - Gjykata Kushtetuese nënshkruan një marrëveshje granti me Konfederatën Zvicerane, të përfaqësuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës, që vepron nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, për realizimin e Projektit të Gjykatës "Rritja e transparencës dhe aksesit në drejtësinë kushtetuese".

Aktivitetet jubilar

25-vjetori i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, 27 nëntor 2023

Me rastin e 25 vjetorit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese dhe Kuvendi i Shqipërisë organizuan konferencën ndërkombëtare me temë “25 vjet të Kushtetutës Shqiptare”, e cila u zhvillua në Sallën e Seancave Plenare të Kuvendit, në datën 27 nëntor 2023. Në këtë aktivitet jubilar, krahas personaliteteve më të larta të shtetit, morën pjesë kryetarë/gjyqtarë të gjykatave kushtetuese homologe, përfaqësues nga Komisioni i Venecias dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, konstitucionalistë të shquar, akademikë, përfaqësues të institucioneve të drejtësisë dhe institucioneve të tjera të pavarura në Shqipëri. Në fjalën e saj, Kryetarja znj. Holta Zaçaj, pasi vuri theksin në atë që përfaqëson Kushtetuta për historinë e popullit tonë dhe aspiratat për të ardhmen e tij evropiane, theksoi rolin e Gjykatës Kushtetuese si rojtare dhe interpretuesja e fundit e Kushtetutës në zhvillimin e demokracisë dhe të drejtësisë kushtetuese, duke qenë ajo e përgjegjshme për ndikimin që ka në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike të vendit. Ajo bëri thirrje për të gjitha palët që të pranojnë verdiktin e Gjykatës, duke qenë kjo sjellja e duhur, e nevojshme dhe e vetme për të zbatuar Kushtetutën. Konferenca i vijoi punimet me sesionin me temë “Një mesazh për Kushtetutën”, gjatë të cilit referuan kryetarë të gjykatave kushtetuese homologe, anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Gjykatës së Lartë, si dhe akademikë të shquar dhe anëtarë të komisionit parlamentar për hartimin e Kushtetutës.



Pjesëmarrje në veprimtari ndërkombëtare dhe vizita studimore

Pjesëmarrje në veprimtari të rëndësishme ndërkombëtare

Forumi i Gjykatave Kushtetuese të Ballkanit, Sofje, 26-28 tetor 2023

Një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga Kryetarja e kësaj Gjykate, znj. Holta Zaçaj, si dhe gjyqtarët z. Sandër Beci dhe z. Ilir Toska, mori pjesë në veprimtaritë e zhvilluara në kuadër të krijimit të Forumit të Gjykatave Kushtetuese të Ballkanit, organizuar në Sofje, Bullgari, në datat 26 - 28 tetor 2023. Synimi i këtij Forumi është nxitja e bashkëpunimit dhe zhvillimi i dialogut mes gjykatave kushtetuese të vendeve të rajonit, duke shërbyer si një platformë për shkëmbimin e rregullt të informacionit dhe praktikave më të mira në fushën e drejtësisë kushtetuese.

Seminar i GJEDNJ-së lidhur me mekanizmin e opinionit këshillimor, Strasburg, 13 tetor 2023

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, znj. Holta Zaçaj, mori pjesë në seminarin e organizuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut me temë "Dialogu gjyqësor nëpërmjet mekanizmit të opinionit këshillimor të parashikuar në Protokollin nr. 16", i cili u zhvillua në Strasburg, Francë, në datën 13 tetor 2023.

Kongresi i 28-të Botëror i Drejtësisë, New York, 20-21 korrik 2023

Kongresi i 28-të Botëror i Drejtësisë u organizua me disa tryeza diskutimesh, ku pati referime nga panelistë të ndryshëm nga e gjithë bota. Përfaqësuesit e Gjykatës Kushtetuese referuan në disa prej paneleve: Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Holta Zaçaj, referoi në panelin me titull: "Liria e shprehjes në epokën digjitale"; gjyqtarja Marsida Xhaferllari në panelin me titull: "Shteti i së drejtës, drejtësia kushtetuese dhe teknologjia"; dhe gjyqtaret Fiona Papajorgji dhe Marjana Semini në panelin me titull: "Universaliteti i shtetit të së drejtës".

Konferencë e përbashkët ndërmjet Gjykatave Kushtetuese dhe të Larta të Shqipërisë dhe Kosovës, Prishtinë, 14 dhjetor 2023

Konferenca me temë "Ekuilibri ndërmjet kontrollit të ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë, kufijtë e juridiksionit dhe qasja në drejtësi" ka mbledhur së bashku në Prishtinë, në datën 14 dhjetor 2023, gjyqtarët e Gjykatave Kushtetuese dhe të Larta të Shqipërisë dhe Kosovës. Në këtë konferencë, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, znj. Elsa Toska dhe znj. Marsida Xhaferllari prezantuan perspektivën e Gjykatës në zbatim të parimeve të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.

Konferencë ndërkombëtare me rastin e 14-vjetorit të krijimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Prishtinë, 23-24 tetor 2023

Një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, i kryesuar nga Kryetarja, znj. Holta Zaçaj, mori pjesë në ceremoninë solemne dhe konferencën ndërkombëtare të organizuar me rastin e përvjetorit të 14-të të Vitit Gjyqësor të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në Prishtinë, në datat 23 dhe 24 tetor 2023.

Në konferencën ndërkombëtare me temë "Kontributi i gjykatave kushtetuese në mbrojtjen dhe forcimin e vlerave themelore të demokracisë, sundimit të ligjit dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut", Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, znj. Holta Zaçaj, mbajti prezantimin e titulluar "Roli i gjykatës kushtetuese si ligjvënës negativ".

Konferencë ndërkombëtare me rastin e 25-vjetorit të Gjykatës Kushtetuese të Azerbajxhanit, Baku, 4-5 korrik 2023

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, znj. Holta Zaçaj, mori pjesë në konferencën ndërkombëtare me temë "Progresi i legjislacionit nëpërmjet zbatimit të normave kushtetuese", e cila u zhvillua në Baku, në datën 4 korrik 2023, me rastin e 25-vjetorit të krijimit të Gjykatës Kushtetuese të Azerbajxhanit. Në këtë konferencë, Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Holta Zaçaj, mbajti prezantimin "Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë në dritën e Reformës në Drejtësi dhe amendimeve kushtetuese — mësimet e nxjerra".

Takimi i Rrjetit të Gjykatave Supreme (SCN), Strasburg, 8 - 9 qershor 2023

Gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, znj. Elsa Toska, e cila është përfaqësuese e kësaj Gjykate në Rrjetin e Gjykatave Supreme (Supreme Courts Network) - forum i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mori pjesë në takimin e 6-të të këtij Rrjeti, i cili i zhvilloi punimet pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, Francë, në datat 8 dhe 9 qershor 2023. Gjyqtarja Elsa Toska u bë pjesë e diskutimeve dy ditore në lidhje me standardet e pavarësisë së gjykatave dhe gjyqtarëve, si dhe përcimin e eksperiencës dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë.

Konferencë ndërkombëtare e organizuar nga Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, Berlin, 4 - 5 maj 2023

Një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, i përbërë nga znj. Holta Zaçaj, Kryetare e Gjykatës, dhe znj. Elsa Toska, gjyqtare, ka marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare me temë "Ndryshimet klimatike si një sfidë për të drejtën kushtetuese dhe gjykatat kushtetuese", e cila u zhvillua në Berlin, Gjermani në datat 4-5 maj 2023.

Kongresi i Federatës Ndërkombëtare për të Drejtën Evropiane, Sofje, 31 maj-3 qershor 2023

Gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Marsida Xhaferllari, ka marrë pjesë në Kongresin e XXX-të të Federatës Ndërkombëtare për të Drejtën Evropiane (FIDE), i cili i zhvilloi punimet në Sofje, Bullgari, në datat 31 maj - 3 qershor 2023. Gjyqtarja Marsida Xhaferllari referoi në panelin e diskutimeve për Shtetin e së Drejtës dhe zgjerimin e Bashkimit Evropian dhe mbajti një prezantim lidhur me perspektivën shqiptare në këtë aspekt.

100-vjetori i miratimit të Kushtetutës së Rumanisë së Madhe, Bukuresht, 27-28 mars 2023.

Një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, i përbërë nga gjyqtaret znj. Fiona Papajorgji dhe znj. Marjana Semini, mori pjesë në asamblenë festive dedikuar 100-vjetorit të miratimit të Kushtetutës së Rumanisë së Madhe të vitit 1923, ceremoni e cila u zhvillua në Pallatin e Parlamentit në Bukuresht, në datën 27 mars 2023.

Vizitat studimore në kuadër të zhvillimit dhe promovimit të marrëdhënieve bilaterale

Vizitë pune në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, Prishtinë, 29-30 qershor 2023

Trupa e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, e kryesuar nga Kryetaria e kësaj Gjykate, znj. Holta Zaçaj, zhvilloi një vizitë pune në Prishtinë, Kosovë, në datat 29 - 30 qershor 2023. Në kuadër të kësaj vizite u organizua një tryezë e përbashkët diskutimesh me pjesëmarrjen e trupave gjyqësore të të dyja gjykatave. Temat e trajtuara gjatë punimeve të kësaj tryeze ishin: "Ankimi kushtetues si e drejtë substanciale dhe gjykimi brenda një kohe të arsyeshme" dhe "Kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjeve për subjektet e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara".

Vizitë pune në Tribunalin Federal të Zvicrës, Lozanë, 7-8 shtator 2023

Një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, i kryesuar nga Kryetaria e kësaj Gjykate, znj. Holta Zaçaj, dhe i përbërë nga gjyqtarët znj. Sonila Bejtja, z. Sandër Beci, z. Ilir Toska dhe z. Gent Ibrahim, zhvilloi një vizitë pune pranë Tribunalit Federal të Zvicrës, në Lozanë, Zvicër, në datat 7-8 shtator 2023. Gjatë takimeve të zhvilluara në kuadër të kësaj vizite me Kryetarin e Tribunalit Federal, z. Yves Donzallaz, dhe me gjyqtarët e tjerë të këtij tribunali, u ndanë përvojat nëpërmjet prezantimeve të paraqitura nga gjyqtarët. Për Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë referuan z. Gent Ibrahim lidhur me "Kontrollin kushtetues të akteve normative" dhe znj. Sonila Bejtja për "Ankimin kushtetues individual", ndërkohe që kolegët zviceranë prezantuan temat e "Ndarjes së pushteteve dhe pavarësisë së gjyqësorit" dhe "Publikimin e vendimeve dhe marrëdhëniet me median".

Vizitë studimore pranë gjykatave të larta suedeze, Stokholm, 26-27 shtator 2023

Një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, në bashkëpunim me Zyrën e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, në kuadër të Projektit 2022-2024 të kësaj të fundit "Mbështetje për forcimin e shtetit të së drejtës", zhvilloi një vizitë studimore pranë Gjykatës Supreme, Gjykatës Supreme Administrative dhe Gjykatës Svea të Apelit të Suedisë. Gjatë kësaj vizite, delegacioni i kryesuar nga gjyqtar z. Gent Ibrahim i prit në takime nga përfaqësues të lartë të gjykatave suedeze dhe u njoh prej tyre lidhur me mënyrën e organizimit dhe funksionimit të sistemit gjyqësor në përgjithësi në Suedi dhe gjykatave të sipërpërmendura në veçanti. Delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë pati mundësinë të njihet në mënyrë më të detajuar me programet e komunikimit me median si dhe me sistemin e dixhitalizuar të menaxhimit të çështjeve.

FOTOGRAFI/ PICTURES

Konferencë e përbashkët ndërmjet Gjykatave Kushtetuese dhe të Larta të Shqipërisë dhe Kosovës, Prishtinë, 14 dhjetor 2023/
Joint conference of constitutional courts and high courts of Albania and Kosovo, Pristina, 14 December 2023



Forumi i Gjykatave Kushtetuese të Ballkanit, Sofje, 26-28 tetor 2023/
Balcan Constitutional Courts Forum, Sofia, 26-28 October 2023



Konferencë ndërkombëtare me rastin e 14-vjetorit të krijimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Prishtinë, 23-24 tetor 2023/
International Conference for the 14th anniversary of Kosovo Constitutional Court, Pristina, 23-24 October 2023



Kongresi i 28-të Botëror i Drejtësisë, Nju Jork, 20-21 korrik 2023/ 2
8th World Congress of Justice, New York, 20-21 July 2023



Konferencë ndërkombëtare me rastin e 25-vjetorit të Gjykatës Kushtetuese të Azerbajxhanit, Baku, 4-5 korrik 2023/
International Conference on the 25th anniversary of Azerbaijan Constitutional Court, Baku, 4-5 July 2023



Takimi i Rrjetit të Gjykatave Supreme (SCN), Strasburg, 8-9 qershor 2023/
Network meeting of Supreme Courts, Strasbourg, 8-9 June 2023

100-vjetori i miratimit të Kushtetutës së Rumanisë së Madhe,
Bukuresht, 27-28 mars 2023/
100 anniversary of Constitution of Great Romania,
Bucharest, 27-28 March, 2023



Konferencë ndërkombëtare e organizuar nga Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, Berlin, 4-5 maj 2023/
International Conference from the Federal Constitutional Court of Germany, Berlin, 4-5 May 2023



Vizitat studimore në kuadër të zhvillimit dhe promovimit të marrëdhënieve bilaterale/Study visits in view of bilateral cooperation

Vizitë pune në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, Prishtinë, 29-30 qershor 2023/
Working visit to the Kosovo Constitutional Court, Pristina, 29-30 June 2023



Vizitë pune në Tribunalin Federal të Zvicrës, Lozanë, 7-8 shtator 2023/
Work visit in Federal Tribunal of Switzerland, Lausanne, 7-8 September 2023



Vizitë studimore pranë gjykatave të larta suedeze, Stokholm, 26-27 shtator 2023/
Study visit to the swedish supreme courts Stockholm, 26-27 September 2023



Aktivitetete të ndryshme të Gjykatës/Various activities of the Court

Tryeza bashkëpunimi mes Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë/
Cooperation roundtables of the Constitutional Court and High Court



Tryeza me gjyqtarët dhe stafin administrativ në funksion të planifikimit strategjik/
Roundtables of judges and administrative staff of the Court in view of strategic planning



Tryeza pune mbi kuadrin e brendshëm rregullator dhe standardizimin e akteve të Gjykatës/
Workshops on the internal regulatory framework and standardization of the Courts' acts





REPUBLIC OF ALBANIA
CONSTITUTIONAL COURT

ANNUAL REPORT
2023





Printed by the Printing House Kristalina-kh

Translation: Adelina Albrahimi

Copyright: © Constitutional Court of the Republic of Albania

Table of contents

Introduction	7
THE CONSTITUTIONAL FRAMEWORK ON THE FUNCTIONING AND ORGANIZATION OF THE COURT	9
Composition of the Court	11
Members	12
 DECISION-MAKING	 20
 STATISTICAL DATA	 45
 COOPERATION AND INTERNATIONAL PERSPECTIVE	 53
Adherence of the Constitutional Court to international bodies	53
Jubilee activities	55
Participation in international activities and study visits	56

Introduction

